



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHITES
Nr.01-060/01-22773/24 datë: 22.08.2024



Npi – 01/269 datë:22.08.2024

Bazuar në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr.28, datë 04.06.2008); Nenit 32, dhe 37 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës Nr.02/2015 të datës 28.12.2015; Si dhe në bazë të nenit 4 dhe 6 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi-01/155 të datës 27.04.2023, Kryesuesi i Kuvendit vendosi të bëjë këtë:

F T E S Ë

PËR MBLEDHJEN E -VIII- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHITES

E cila do të mbahet në sallën e Kuvendit më: 30.08.2024 (e premte) Në ora: 09:00h

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 04.07.2024,
2. Raporti i auditimit të ZKA-së për pasqyrat financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2023,
3. Plani i veprimt për adresimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2023,
4. Raporti buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Qershor 2024,
5. Draft-Buxheti i Komunës së Shtimes për vitin 2025 (për diskutim publik),
6. Propozim-Vendim për anulimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/189 dt.06.09.2012, për dhënjën në shfrytëzim sipërfaqen prej 50 ari truall, Policisë së Kosovës njësia në Shtime,
7. Propozim-Vendim për formimin e komisionit për emertimin e Objekteve Publike,
8. Propozim-Vendim për formimin e komisionit për emerimin e Rrugeve dhe Shesheve,
9. Informatë nga DKA për përfundimin e vitit mësuesor 2023-2024 në Komunën e Shtimes,
10. Pyetje – Përgjigje.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit

Data/Datum/Date:	19.08.2024
Nr./Br./No	02/ 823
Për/Za/To:	Komitetin për Politikë dhe Financa - Kuvendin Komunal Shtime
Nga/Od/From:	Qemajl Aliu, Kryetar Komune
Lënda/Predmet/Subject :	Plani i Veprimit për adresimin e Rekomandimeve të dhëna nga raporti i Zyrës Kombëtare të Auditorit (ZKA) për Pasqyrat Financiare Vjetore të Perfundura me 31 dhjetor 2023

Të nderuar/a

Më lejoni që përmes kësaj shkres të ju njoftoj se sipas nenit 23, pika 5 të Ligjit nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyren Kombëtare të Auditimit, brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të raportit final të auditimit, çdo institucion i audituar është i obliguar ta dorëzojë një Plan të Veprimit ku përcaktohen se si do t'i adresoj rekomandimet e dhëna në raport.

Gjithashtu gjeni të bashkangjitur dokumentin e planit të veprimit.

Me respekt!

Adresa: Rr. Tahir Sinani, 72000 Shtime, Republika e Kosovës. Tel.: +381290389016



Për Zyren Kombëtare të Auditimit

Nga z. Qemajl Aliu, Kryetar i Komunitës

Date: 18.07.2024, Shkime

**PLAN I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE**
të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra
Kombëtare e Auditimit

Gjetjet dhe rekomandimet nga viti 2023

Nr.	Komponent a e auditimit(k apitull)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtarët/ përgjegjës	Data e planifik uar e zbatimit të rekom andimit	Komente
1	A1 - Prezantim jo i plotë dhe i saktë i llogarive të arkëtueshme në PVF	Sipas nenit 6 të Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parashihet se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare". Sipas nenit 7 Paragrafi 2.6.2 i shtojcës së Ligjit Nr. 04/1-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), pjesa II Procedurat Filleshare parashihet njëjftimisht që: "Përshihin një deklaratë të qartë se të gjithë personat që pretendojnë se kanë Kërkesa dhe/apo interesa ndaj ndërmarrjes apo asetëve të ndërmarrjes duhet të parashirojnë Dëshmi të Kërkesës dhe/apo Dëshmi të Interesit me anë të formularit përkates bashkë me të gjitha dokumentet mbështetëse brenda Afatit për parashkrimin e kërkesave, që do të caktohet në 16:00 në një ditë pune dyzetepesë (45) ditë pas darës në të cilën është publikuar në tërësi Njoftimi për likuidim në pajtim me të gjitha kërkesat e	Kryetari duhet të sigurojë zyrtarët përgjegjës mbajnë evidencën të plotë dhe të saktë për logaritë arkëtueshme dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të sigurohet se prezantimi i tyre në PVF është i plotë dhe i saktë. Gjithashtu, Kryetari duhet të sigurohet që zyrtarët përgjegjës të respektojnë afatet kohore për parashkrimin e kërkesave kreditore me	Hapi i parë: Përpunimi i një raporti detaj për ish ndërmarrjet shogërore të cilat menaxhohen nga AKP. Hapi i Dytë: Takimi me AKP-në dhe pregaditja dhe dorëzimi i kërkesës për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të precizuar listën e ndërmarrjeve të cilit nuk kanë plotësuar formularin sipas nenit 7 Paragrafi 2.6.2 i shtojcës së Ligjit Nr.	Drejtori për Buxhet dhe Financa Menaxheri i zyrës së Tatumit në Pronë	TM3 - TM4 2024	

	<p>aplikueshme të Dispozitivave për Shpallje".</p> <p>Komuna në tri (3) raste ka bërë prezantim jo të plotë dhe të saktë të llogarive të arkëtueshme në PVF për 15,500€, për gabimet e hasura si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Llogaritë e Arkëtueshme nga fatimi në pronë ish-in mbivlerësuar për 14,460€, pasiqë komuna nuk ka ofruar dëshmi që i japin të drejtën për arkëtimin e këtyre mjeteve. Sipas dëshmive të siguruara nga ana jonë, AKP kishte iniciuar procesin e likuidimit të N.SH. Kooperativa Bujqësore Shtime me datë 09.09.2013. Ndërsa, komuna nuk kishte bërë kërkesë për mbledhjen e tatimit në pronë brenda afatit kohor prej 45 dite nga njoftimi i AKP-së, e cila kishte paraparë afatin për pranimin e kërkesave nga data 18.09.2013 deri me 01.11.2013, gjatë kësaj periudhe komuna ka pasur afat 45 ditë për parashkrimin e kërkesave kreditore ndërsa komuna kërkesën e ka bërë me datë 27.12.2023, për çka komuna i ka humbur afatet për të parashtruar kërkesën për mbledhjen e këtyre llogarive të arkëtueshme dhe ligjërisht nuk ka të drejtë juridike që të kërkoj arkëtimin e këtyre mjeteve. Llogaritë e arkëtueshme nga qiraja për shtfytëzimin e pronës komunale ishin mbivlerësuar për 1,040€. <p>Kjo ka ndodhë pasi që zyrtarët përgjegjës komunal nuk kanë ndërmarrur veprimet për të dorëzuar kërkesën pranë AKP-së për</p>	<p>rastin hyrjes së Ndërmarrjeve Shqiptare në llogaritë nga Agjencia e Kosovës për Privatizim (AKP).</p>	<p>04/1-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), pjesa II Procedurat Fillestare parashtruar nga njoftimi që: "Përfaqshin një deklaratë të qartë se të gjithë personat që pretendojnë se kanë Kërkesa dhe/apo interes ndaj ndërmarrjes apo asetëve të ndërmarrjes duhet të parashtrtojnë.</p> <p>Hapi Tretë : Procedimi i kërkesës për kuvend Komunal për nxjerrjen e vendimit për fshirjen e këtyre obligimeve .</p> <p>Hapi Katërt : Fshirja në programin Protax të</p>			
--	--	--	---	--	--	--

	<p>tatimin në pronë të mbledhur ndër vite brenda afatit të përcaktuar ligjor. Si dhe, funksionimit jo efikas të kontrolleve të brendshme në azhurnimin e regjistrave kontabël dhe ruajtjen e dokumentacionit.</p>	<p>Kryetari duhet të vazhdoj përpjekjet në bashkëpunim me MF për të zgjidhur çështjen e planifikimit dhe realizimit të buxhetit për pagesat e parapara me kontratën kolektive në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PVF sipas standardeve të kontabilitetit në përputhje me planin kontabël.</p>	<p>obligimeve sipas kërkesës dhe vendimit të Kuvendit Komunal</p>	<p>Hapi i parë: Evidencimi i Obligimeve të cilat rrjedhin nga kontrata kolektive dhe klasifikimi i tyre në ato të cilat i kanë përfunduar të gjitha procedurat dhe ato obligime të cilat janë në proces. Hapi i dytë: Trajtimi me departamentin e thesarit të kësaj teme - Obligimet kontigjente si hapja e Kodeve të reja, apo edhe rritja e buxhetit në kategorin e pagave. Hapi i Tretë: Prgaaditja e KAB për vitin vijues dhe</p>	<p>Drejtoria për buxhet dhe Financa- ZKRF Zyra Ligjore</p>	<p>TM3 - TM4 2024</p>
<p>2</p>	<p>B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve</p>	<p>Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Shpenzimi i parashë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.</p> <p>Në shtatë (7) raste kemi identifikuar se thesari nga llogaria e komunës kishte ekzekutuar pagesa në kategori ekonomike jo adekuate në vlerë prej 232,213 E si:</p> <ul style="list-style-type: none"> Nga kategoria mallra dhe shërbime vlera prej 15,826€, ishte paguar për Investime kapitale, 11,750€ ishin paguar për subvencione dhe transfere dhe 64,071€ ishin paguar për paga dhe mëdijë, shpenzime të ndodhura sipas kontratës kolektive. Nga kategoria subvencione dhe transfere vlera prej 66,903€, ishte paguar për paga dhe mëdijë, shpenzime të ndodhura sipas kontratës kolektive. Nga kategoria e investimeve kapitale vlera prej 73,663€, ishte paguar për paga dhe mëdijë, shpenzime të ndodhura sipas kontratës kolektive. 	<p>Kryetari duhet të vazhdoj përpjekjet në bashkëpunim me MF për të zgjidhur çështjen e planifikimit dhe realizimit të buxhetit për pagesat e parapara me kontratën kolektive në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PVF sipas standardeve të kontabilitetit në përputhje me planin kontabël.</p>	<p>Hapi i parë: Evidencimi i Obligimeve të cilat rrjedhin nga kontrata kolektive dhe klasifikimi i tyre në ato të cilat i kanë përfunduar të gjitha procedurat dhe ato obligime të cilat janë në proces. Hapi i dytë: Trajtimi me departamentin e thesarit të kësaj teme - Obligimet kontigjente si hapja e Kodeve të reja, apo edhe rritja e buxhetit në kategorin e pagave. Hapi i Tretë: Prgaaditja e KAB për vitin vijues dhe</p>	<p>Drejtoria për buxhet dhe Financa- ZKRF Zyra Ligjore</p>	<p>TM3 - TM4 2024</p>

	<p>Pas realizimit të pagesave nga thesari, komuna kishite bërë dita kërkesa në thesar që pagesat të kryhen (regjistrohen) nga kategoria e pagave. Megjithatë, këto kërkesa nuk ishin marrë parasysh nga thesari, prandaj regjistrimi i shpenzimit për këto pagesa ka mbetur i njëjtë.</p> <p>Pagesat për paga jubiliare dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet, si dhe komuna nuk kishite bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.</p>		<p>kodimi i mjeteve për pagesën e obligimeve të cilat kanë kaluar të gjitha proceset.</p>			
<p>3</p> <p>B2 - Prezantim jo i drejtë i deyrimeve kontigjente në PVF</p>	<p>Neni 6 i Rregullores MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parashih se: "Organizatat buxhetore mbajjnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhuruar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".</p> <p>Komuna në gjashtë(6) raste, ka bërë prezantim jo të drejtë të deyrimeve kontigjente në PVF për 616,269€ për gabimet e hasura si më poshtë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Detyrimet Kontigjente janë mbivlerësuar për 615,143€, si shkak i prezantimit të lëndëve të cilat kanë qenë vendime gjyqësore të formës së prerë, dhe për të cilat komuna nuk kishite ushtruar ankesë në nivele më të larta. • Detyrimet Kontigjente janë nënvlerësuar për 1,126€, si pasojë e mos 	<p>Kryetari duhet të sigurojë se deyrimet kontigjente të prezantohen në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore</p>	<p>Hapi i parë: Përgaditja e një raporti detajal për obligimet kontigjente.</p> <p>Hapi i dytë: Takime me departamentin e thesarit për gjetjen e mundësis për pagesën e obligimeve kontigjente.</p> <p>Hapi i Tretë: Buxhetimi i shumës për obligimet të cilat kanë marrë</p>	<p>Drejtoria përkatëse ZKPF</p> <p>Zyra Ligjore</p>	<p>TM3 - TM4 2024</p>	

	<p>përfshirjes së lëndëve me të gjitha shpenzimet e parapara për të cilat detyrohet komuna.</p> <p>Prezantimi jo i plotë dhe saktë i detyrimeve kontingjente në PVF kishte ndodhur për shkak se personat përgjegjës nuk kishin azhurnuar vlerën e detyrimeve kontingjente të prezantuar në raport e pastaj edhe në PVF</p>		<p>formën e prerë, pas konsultimit me Ministrinë e Financave për kodimin e mjeteve për procedim.</p>	<p>Drejtorit të cilat në buxhetin e aprovuar kanë mjete në kategorinë e subvencioneve</p>	<p>TM3 – TM4 2024</p>	
<p>B3 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve dhe transferëve</p>	<p>Sipas nenit 20 të Rregullores së brendshme të komunës për ndarjen e subvencioneve Nr. 01/060/01-24495/17 i datës 16.08.2017, dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat fizik përfshijnë ndër të tjera: numrin identifikues të fermerit, projektin financiar, fletë posedimin për paturndshmeri, dëshmi për pagesën e taksave komunale, dëshmi mbi pagesën e tatimit në pronë, konfirmimin nga banka për xhirologarinë e aplikuesit. Gjithashtu, sipas thirrjes publike për aplikim për farë misri të datës 14.02.2023 dhe Nr. 04/05 kriteret që duhet ti plotësoj përfuturi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të jetë banor i Komunës së Shitimes; • Toka të jetë e përshtatshme për kultivimin e misrit; • Aplikuesit përfutur të subvencioneve të misrit për vitin 2022 dhe • Aplikuesit për mbajtje deri në dy (2) ha me misër. <p>Thirrja publike për subvencionimin e fermerëve në bujqësi për furnizim me farë misri ishte përcjell me parregullsitë si në</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme për forcimin e kontrollave të brendshme në mënyrë që dokumentet e nevojshme për subvencionimin e fermerëve të jenë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e përcaktuara me rregulloren e brendshme të komunës për subvencione. Gjithashtu duhet të sigurohet që gjatë vlerësimit të aplikacioneve të respektohen kriteret e</p>	<p>Hapi i Parë: Pregaditja e planit vjetor për ndarjen e subvencioneve.</p> <p>Hapi i dytë: Formimi i komisionit për ndarjen e subvencioneve.</p> <p>Hapi tretë: Thirrjet publike dhe specifikimi i detajuar për aplikim duke u mbështetur Rregulloren e brendshme të komunës për ndarjen e subvencioneve.</p>			

		<p>vijim:</p> <ul style="list-style-type: none">• Thirrja publike për subvencionimin e fermerëve në bujqësi nuk kishite parashikuar që aplikuesit/përfituesit të dorëzonin projekt financiarë dhe fletën poseduese për pronësi që janë kërkesa të rregullores së brendshme të komunës.• Një mostër e testuar kishite rezultuar që përfitues kishite dorëzuar aplikacionin me datë 09.03.2023, derisa afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve sipas thirrjes ishte 06.03.2023.• Sipas thirrjes publike për subvencionimin e fermerëve në bujqësi aplikuesit duhet të jenë përfitues të subvencioneve të misrit në vitin paraprak, pra për vitin 2022 në mënyrë që të kualifikohen për subvencionimin për vitin 2023. Pra komuna kishite pamundësuar përfitimim e subvencioneve nga fermerët e rinj.• Sipas thirrjes publike për aplikimin për farë misri të dates 14.02.2023, me nr.04/05, ndër kriteret që duhet ti plotësoj përfituesi ishte që aplikuesit duhet të kenë për mbjellje deri në 2ha. Nga shqyrtimi i dosjes për subvencionim me farë të misrit, ne kemi vërejtur se 134 përfitues nga gjithsej 198 apo 68% e tyre kishin sipërfaqe për mbjellje të misrit mbi 2ha. <p>Kjo ka ndodh për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme gjatë përgatitjes së thirrjes publike dhe</p>	vendosura në thirrje.				
--	--	---	-----------------------	--	--	--	--

	vlerësimi të dosjeve të aplikuesve për subvencione.	Kryetari të sigurojë forcimin e kontroleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara si dhe të gjitha projektet ekzekutuese të vendosen në platformën e-prokurimit.	Hapi i Parë: Kontraktimi i operatorit ekonomik për përgaditjen e projekteve detajë. Hapi i dytë: Procedimi me projekte për nisjen procedurave me pëshkrimin të hollësishëm të projektit.	Kryetari Drejtoria e Urbanizmit Drejtoria e prokurimit Menaxheri i prokurimit	TM3 - TM4 2024	
5	B4 - Mungesa e projektit ekzekutues dhe mos vendosja e tyre në platformën e prokurimit	Në një (1) rast kemi vërejtur se komuna ka iniciuar procedura të prokurimit dhe kishite lidhur kontratë për projektin Renovimi i objekteve shëndetësore në vlerë 59,237€ pa hartuar paraprakisht projektin ekzekutiv të ndërtimit. Po ashtu në pesë raste (5) autoriteti kontraktues i kishite përgatitur projektet ekzekutive, por nuk i kishite bashkangjitur në platformën e-prokurimi, siç janë: Rregullimi i parkut Sheshit në qytetin e Shtimes Faza IV me vlerë 147,882€, Rregullimi				

	<p>ngarkuar në sistem të gjitha ato materiale elektronike voluminoze.</p>			<p>Kryetari Drejtoria e Ekonomisë Drejtoria e Urbanizimit dhe Kataster</p>	<p>TM3 – TM4 2024</p>	
<p>6. A2 - Shkelje e kushteve të kontratës nga ana e shfrytëzuesit të pronës komunale</p>	<p>Sipas neni 19 paragrafi 5 të ligjit 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, e drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajshme nuk mund të bartet në shfrytëzim të personat e tretë. Ndërsa sipas neni 4.8 të kontratës nr. 02/438 të dt. 30/06/2019 për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale, shfrytëzuesi nuk ka të drejtë në asnjë mënyrë që ngasitën kadastrale të marrë në shfrytëzim ta bart të personi i tretë me qira apo në çfarëdo mënyrë tjetër.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë menaxhim efikas të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, duke raportuar në raportet e tij gjashtë (6) mujore për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave nga shfrytëzuesit e pronës në raport me kushtet e përcaktuara në kontratë, në mënyrë që mos ju ipet prona palëve të treta për të cilat nuk e lejon legjislacioni në fuqi.</p>	<p>Hapi i parë: Mbatja e një takimi informues me shfrytëzuesit e pronave komunale sipas vendimeve për shfrytëzim, dhe informimi në detaje për të drejtat e shfrytëzimit të pronës komunale. Hapi i dytë: Monitorimi në periudha të caktuara për shfrytëzimin e hapësirave/pronave dhe përgaditja e raporteve detajë për pronat të cilat janë dhënë në shfrytëzim. Hapi i tretë: Ndermarrja e masa për moszbatimin e ligjit 06/L-092 për dhënie në</p>			

	<p>Mungesa e vendosjes së një mekanizmi efektiv për monitorimin e procesit të pronave komunale të cilat janë dhënë në shfrytëzim ka bërë që shfrytëzuesi i kontraktuar të pronës komunale ta jap tek palët e treta.</p>		<p>shfrytëzim të pronës komunale.</p>			
<p>7. A3 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimi</p>	<p>Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parashih se "Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistemin të prokurimit elektronik".</p> <p>Menaxherët e kontratave/projekteve nuk e kanë mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik, menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve.</p> <p>Kjo ka ndodh si rezultat i mungesës së funksionimit të kontrolleve të brendshme për ta kryer këtë proces nga ana e menaxherëve të projekteve.</p>	<p>Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për ta siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.</p>	<p>Hapi i parë: Zyra e prokurimit të angazhohet vazhdimisht për menaxhimin e kontratave përmes platformës E-Prokurimi. Hapi i Dytë: Kërkesa për trajnimë shtesë nëse është e nevojshme për menaxhimin e kontratave përmes Platformës E-Prokurimi</p>	<p>Kryetari Drejtorja e Buxhet dhe Financa Menaxheri i zyrës Tatimit në Pronë</p>	<p>TM3 - TM4 2024</p>	
<p>8. B5- Eftikasitet i ulët në menaxhimin e Llogaritve të Arkëtueshme</p>	<p>Sipas nenin 26 të ligjit për tatimin në pronën e pabujshme Nr. 06/L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbartese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të paguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27, nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur mekanizma adekuat me</p>	<p>Hapi parë Nxjerrja e raportit detaj nga programi PRQTAx 2002-2023. Hapi dytë Identifikimi i</p>	<p>Kryetari Drejtorja Buxhet dhe Financa Menaxheri i zyrës Tatimit në Pronë</p>	<p>TM3 - TM4 2024</p>	

<p>dhe gjithë nëse ka të kërillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.</p>	<p>qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.</p>	<p>obliguesve AKP, subjekte juridike, qytetar.</p> <p>Hapi tretë Takime me palët obliguese (borgjilnjtë)</p> <p>Hapi katërt Veprimi konkret përmasave ligjore</p> <p>Nga vërejtjet me shkrim deri në përmbartim</p>			
<p>Sipas regjistrave të llogarive të arkëtueshme, vlera e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2023 ishte 530,004€. Sfida kryesore mbetet arkëtimi i tatimit në pronë dhe atë për vitet paraprake, edhe përkundër faktit që komuna gjatë vitit 2023 kishte ndërmarrë veprime për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme duke dërguar letrë rikujtimin për detyrimet e papaguara tek tatimpaguesit, komuna nuk kishte ndërmarrë masa shtesë konkrete (përveç letrë rikujtimit) si ajo e veprimeve ligjore përmasive përmbartimit për mbledhjen/realizimin e llogarive të Arkëtueshme.</p>					
<p>Dobësitë e identifikuar lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efektive në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre.</p>					

Vërejtje: Ky raport ka rezultuar me (tetë) 8 rekomandime, prej tyre tre (3) janë rekomandime të reja dhe pesë (5) të përsëritura, rekomandimet me shkronjën A janë rekomandime të reja, ndërsa rekomandimet me shkronjën B janë të vitit paraprak.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit

Data/Datum/Date:	19.08.2024
Nr./Br./No	02/ 896
Për/Za/To:	Komitetin për Politikë dhe Financa Kuvendin Komunal Shtime
Nga/Od/From:	Qemajl Aliu, Kryetar Komunes
Lënda/Predmet/Subject :	Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Shtimes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 nga Zyra Kombëtare e Auditorit (ZKA)

Të nderuar/a

Më lejoni që përmes kësaj shkres të ju njoftoj për:

- Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Shtimes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023- Nr. i Dokumentit: 04/47/890 i datës 19.06.2024 të kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit në Kosovë.

Gjithashtu gjeni të bashkangjitur dokumentin e raportit.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SHITES PËR VITIN 2023

Raport i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, maj 2024

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmblodhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Shtëmës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtëmës (KSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Shtëmës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Prezantim jo i plotë dhe i saktë i llogarive të arkëtueshme në PVF në vlerë prej 15,500€.
- B1 Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë 232,213€.
- B2 Prezantim jo i plotë dhe i saktë i detyrimeve kontigjente në PVF në vlerë prej 616,269€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

Konkluzion për pajtueshmërinë

Në kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Shtimes kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B3 Parregullsi në ftesën publike për subvencionim të fermerëve dhe në përzgjedhjen e tyre.
B4 Komuna kishte iniciuar procedurat e prokurimit pa një projekt detal (ekzekutiv) të ndërtimit.
Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Shtimes.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Shtimes është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Shtimes në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Shtimit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Shtimit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA-REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Dobësitë e evidentuara janë vërejtur në fushat të rëndësishme financiare si: Prezantim jo i plotë dhe i saktë i llogarive të arkëtueshme dhe i detyrimeve kontingjente në PVF, klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve, mungesa e projektit ekzekutues, dobësitë në menaxhimin e obligimeve dhe shpenzimet shtesë përmbartimore, etj. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Po ashtu, është e rëndësishme të theksojmë se nga analiza e raportit të shpenzimeve rezultojnë se vonesat në kryerjen e obligimeve financiare kanë shkaktuar shpenzime shtesë për mes proceseve gjyqësore/përmbartimore. Këto pagesa janë realizuar nga buxheti i komunës për vitin 2023, në një vlerë prej 464,360€. Nga kjo vlerë 342,519€ ishte borxhi kryesor i papaguar, ndërsa 121,841€ janë shpenzime shtesë të realizuara për proceset kontestimore/përmbartimore ose interesat e tjera të përfshira.

Ky raport ka rezultuar me (tetë) 8 rekomandime, prej tyre tre (3) janë rekomandime të reja dhe pesë (5) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Prezantim jo i plotë dhe i saktë i llogarive të arkëtueshme në PVF

Gjetja

Sipas nenit 6 të Rregullores Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Sipas nenit 7 Paragrafi 2.6.2 i shtojcës së Ligjit Nr. 04/l-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), pjesa II Procedurat Fillestare parasheh njoftimin që: "Përfshin një deklaratë të qartë se të gjithë personat që pretendojnë se kanë Kërkesa dhe/apo interesa ndaj ndërmarrjes apo aseteve të ndërmarrjes duhet të parashtrajnë Dëshmi të Kërkesës dhe/apo Dëshmi të Interesit me anë të formularit përkatës bashkë me të gjitha dokumentet mbështetëse brenda Afatit për parashtrimin e kërkesave, që do të caktohet në 16:00 në një ditë pune dyzetepesë (45) ditë pas datës në të cilën është publikuar në tërësi Njoftimi për likuidim në pajtim me të gjitha kërkesat e aplikueshme të Dispozitave për Shpallje".

Komuna në tri (3) raste ka bërë prezantim jo të plotë dhe të saktë të llogarive të arkëtueshme në PVF për 15,500€, për gabimet e hasura si më poshtë:

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

- Llogaritë e Arkëtueshme nga tatimi në pronë ishin mbivlerësuar për 14,460€, pasi që komuna nuk ka ofruar dëshmi që i japin të drejtën për arkëtimin e këtyre mjeteve. Sipas dëshmime të siguruara nga ana jonë, AKP kishte inicuar procesin e likuidimit të N.SH. Kooperativa Bujqësore Shtime me datë 09.09.2013. Ndërsa, komuna nuk kishte bërë kërkesë për mbledhjen e tatimit në pronë brenda afatit kohor prej 45 dite nga njoftimi i AKP-së, e cila kishte paraparë afatin për pranimin e kërkesave nga data 18.09.2013 deri me 01.11.2013, gjatë kësaj periudhe komuna ka pasur afat 45 ditë për parashtrimin e kërkesave kreditorë ndërsa komuna kërkesën e ka bërë me datë 27.12.2023, për çka komuna i ka humbur afatet për të parashtruar kërkesën për mbledhjen e këtyre llogarive të arkëtueshme dhe ligjërisht nuk ka të drejtë Juridike që të kërkoj arkëtimin e këtyre mjeteve.
- llogaritë e arkëtueshme nga qiraja për shfrytëzimin e pronës komunale ishin mbivlerësuar për 1,040€.

Kjo ka ndodhë pasi që zyrtarët përgjegjës komunal nuk kanë ndërmarr veprime për të dorëzuar kërkesën pranë AKP-së për tatimin në pronë të mbledhur ndër vite brenda afatit të përcaktuar ligjor. Si dhe, funksionimit jo efikas të kontroleve të brendshme në azhurnimin e regjistrave kontabël dhe ruajtjen e dokumentacionit.

Ndikimi

Prezantimi i llogarive të arkëtueshme në vlerë jo të plotë dhe të saktë, ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën llogarive të arkëtueshme.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidencë të plotë dhe të saktë për llogaritë e arkëtueshme dhe Zyrtari Kryesor Financiar duhet të sigurohet se prezantimi i tyre në PVF është i plotë dhe i saktë. Gjithashtu, Kryetari duhet të sigurohet që zyrtarët përgjegjës të respektojnë afatet kohore për parashtrimin e kërkesave kreditorë me rastin hyrjes së Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim nga Agjencia e Kosovës për Privatizim (AKP).

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve.**Gjetja**

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Shpenzimi i parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Në shtatë (7) raste kemi identifikuar se thesari nga llogaria e komunës kishte ekzekutuar pagesa në kategori ekonomike jo adekuate në vlerë prej 232,213€ si:

- Nga kategoria mallra dhe shërbime vlera prej 15,826€, ishte paguar për Investime kapitale, 11,750€ ishin paguar për subvencione dhe transfere dhe 64,071€ ishin paguar për paga dhe mëditje, shpenzime të ndodhura sipas kontratës kolektive.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

- Nga kategoria subvencione dhe transfere vlera prej 66,903€, ishte paguar për paga dhe mëditje, shpenzime të ndodhura sipas kontratës kolektive.
- Nga kategoria e investimeve kapitale vlera prej 73,663€, ishte paguar për paga dhe mëditje, shpenzime të ndodhura sipas kontratës kolektive.

Pas realizimit të pagesave nga thesari, komuna kishte bërë disa kërkesa në thesar që pagesat të kryhen (regjistrohen) nga kategoria e pagave. Megjithatë, këto kërkesa nuk ishin marrë parasysh nga thesari, prandaj regjistrimi i shpenzimit për këto pagesa ka mbetur i njëjtë.

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet, si dhe komuna nuk kishte bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të raportimit të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

Ndikimi

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në Pasqyra Vjetore Financiare.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të vazhdojë përpjekjet në bashkëpunim me MF për të zgjidhur çështjen e planifikimit dhe realizimit të buxhetit për pagesat e parapara me kontratën kolektive në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PVF sipas standardeve të kontabilitetit në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Prezantim jo i drejtë i detyrimeve kontingjente në PVF**Gjetja**

Neni 6 i Rregullores MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Komuna në gjashtë(6) raste, ka bërë prezantim jo të drejtë të detyrimeve kontingjente në PVF për 616,269€ për gabimet e hasura si më poshtë

- Detyrimet Kontingjente janë mbivlerësuar për 615,143€, si shkak i prezantimit të lëndëve të cilat kanë qenë vendime gjyqësore të formës së prerë, dhe për të cilat komuna nuk kishte ushtruar ankesë në nivele më të larta.
- Detyrimet Kontingjente janë nënvlerësuar për 1,126€, si pasojë e mos përfshirjes së lëndëve me të gjitha shpenzimet e parapara për të cilat detyrohet komuna.

Prezantimi jo i plotë dhe saktë i detyrimeve kontingjente në PVF kishte ndodhur për shkak se personat përgjegjës nuk kishin azhurnuar vlerën e detyrimeve kontingjente të prezantuar në raport e pastaj edhe në PVF.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

Ndikimi Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të plota dhe të sakta ndikon në mbivlerësimin apo nënvlerësimin e tyre, si dhe palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF-ve të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën e detyrimeve që komuna pritet të ketë në të ardhmen.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se detyrimet kontingjente të prezantohen në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B3 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve dhe transfereve

Gjetja

Sipas nenit 20 të Rregullores së brendshme të komunës për ndarjen e subvencioneve Nr. 01/060/01-24495/17 i datës 16.08.2017, dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për bujqësi nga personat fizik përfshijnë ndër të tjera: numrin identifikues të fermerit, projektin financiar, fletë posedimin për patundshmëri, dëshmi për pagesën e taksave komunale, dëshmi mbi pagesën e tatimit në pronë, konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit. Gjithashtu, sipas thirrjes publike për aplikim për farë misri të datës 14.02.2023 dhe Nr. 04/05 kriteret që duhet të plotësoj përfituesi janë:

- Të jetë banor i Komunës së Shtimes;
- Toka të jetë e përshtatshme për kultivimin e misrit;
- Aplikuesit përfitues të subvencioneve të misrit për vitin 2022 dhe
- Aplikuesit për mbjellje deri në dy (2) ha me misër.

Thirrja publike për subvencionimin e fermerëve në bujqësi për furnizim me farë misri ishte përcjell me parregullsitë si në vijim:

- Thirrja publike për subvencionimin e fermerëve në bujqësi nuk kishte parashikuar që aplikuesit/përfituesit të dorëzonin projekt financiarë dhe fletën poseduese për pronësi që janë kërkesa të rregullores së brendshme të komunës.
- Një mostër e testuar kishte rezultuar që përfitues kishte dorëzuar aplikacionin me datë 09.03.2023, derisa afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve sipas thirrjes ishte 06.03.2023.
- Sipas thirrjes publike për subvencionimin e fermerëve në bujqësi aplikuesit duhet të jenë përfitues të subvencioneve të misrit në vitin paraprak, pra për vitin 2022 në mënyrë që të kualifikohen për subvencionim për vitin 2023. Pra komuna kishte pamundësuar përfitimimin e subvencioneve nga fermerët e rinjë.
- Sipas thirrjes publike për aplikim për farë misri të datës 14.02.2023, me nr.04/05, ndër kriteret që duhet të plotësoj përfituesi ishte që aplikuesit duhet të kenë për mbjellje deri në 2ha. Nga shqyrtimi i dosjes për subvencionim me farë të misrit, ne kemi vërejtur se 134 përfitues nga gjithsej 198 apo 68% e tyre kishin sipërfaqe për mbjellje të misrit mbi 2ha.

Kjo ka ndodh për shkak të mos funksionimit të kontroleve të brendshme gjatë përgatitjes së thirrjes publike dhe vlerësimit të dosjeve të aplikuesve për subvencione.

Ndikimi

Thirrja publike jo në pajtim me rregulloren dhe mos përfillja e kriterëve të thirrjes nga ana e komisionit vlerësues, rrit rrezikun që subvencionet e dhëna të mos arrijnë qëllimin për të cilën janë destinuar derisa në të njëjtën kohë diskriminon përfituesit potencial të thirrjes.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme për forcimin e kontroleve të brendshme në mënyrë që dokumentat e nevojshme për subvencionimin e fermerëve të jenë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

përcaktuara me rregulloren e brendshme të komunës për subvencione. Gjithashtu duhet të sigurohet që gjatë vlerësimit të aplikacioneve të respektohen kriteret e vendosura në thirrje.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B4 - Mungesa e projektit ekzekutues dhe mos vendosja e tyre në platformën e-prokurimit**Gjeja**

Paragrafi 19.17 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik ndër tjerash parasheh se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit".

Në një (1) rast kemi vërejtur se komuna ka iniciuar procedura të prokurimit dhe kishte lidhur kontratë për projektin. Renovimi i objekteve shëndetësore në vlerë 59,237€ pa hartuar paraprakisht projektin ekzekutiv të ndërtimit.

Po ashtu në pesë raste (5) autoriteti kontraktues i kishte përgatitur projektet ekzekutive, por nuk i kishte bashkëngjitur në platformën e-prokurimi, siç janë: Rregullimi i parkut Sheshit në qytetin e Shtimes Faza IV me vlerë 147,882€, Rregullimi i vendndalesave të autobusëve në fshatra me vlerë 68,273€, Rrethojat e fushave sportive në fshatrat Carralevë, Petrovë dhe Davidovc me vlerë 59,168€, Rregullimi i parkut të Pishave në Shtime-Faza IV me vlerë 44,918€, Rregullimi, përmirësimi infrastrukturës në Komunën e Shtimes me vlerë 84,601€, autoriteti kontraktues i kishte përgatitur projektet ekzekutive, por nuk i kishte bashkëngjitur në platformën e-prokurimi projektin ekzekutiv përkatës.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së planifikimit të duhur para fillimit të procedurave të prokurimit, duke përfshirë mungesën e hartimit të projektit ekzekutiv për projektet specifike, si dhe mungesa e kontrolleve jo adekuate për të vendosur projektet ekzekutive në platformën e-prokurimit. Mos bashkëngjitja e projekteve ekzekutive në platformën e-prokurimi, sipas zyrtareve të komunës, kishte ndodh për shkak të mos përkrahjes teknike të platformës e-prokurimi, shkak i hapësirës së pamjaftueshme për të ngarkuar në sistem të gjitha ato materiale elektronike voluminoze.

Ndikimi

Mungesa e projektit ekzekutues mund të shkaktoj vështirësi në realizimin e projekteve gjatë fazës së ekzekutimit, dhe rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi B4

Kryetari të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara si dhe të gjitha projektet ekzekutive të vendosen në platformën e-prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Shtëmës për vitin 2023 ishin në vlerë prej 902,172€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, në vlerë prej 332,448€, (në këtë shumë përfshihet edhe Tatimi në Tokë), si dhe të hyrat tjera jo tatimore në vlerën prej 568,302€ (të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj, si dhe të hyrat tjera në vlerë 1,422€. Në totalin e të hyrave të realizuara janë përfshirë edhe të hyrat indirekte nga gjobat në Trafik në vlerë prej 134,931€ dhe të hyrat nga Agjencia e Pyjeve 242€.

Çështja A2 - Shkelje e kushteve të kontratës nga ana e shfrytëzuesit të pronës komunale

Gjethja

Sipas neni 19 paragrafi 5 të ligjit 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, e drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme nuk mund të bartet në shfrytëzim të personat e tretë. Ndërsa sipas neni 4.8 të kontratës nr. 02/438 të dt. 30/06/2019 për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale, shfrytëzuesi nuk ka të drejtë në asnjë mënyrë që ngastrën kadastrale të marrë në shfrytëzim ta bart të personi i tretë me qira apo në çfarëdo mënyre tjetër.

Në vendimin e datës 31.05.2019, nxjerrë nga Kuvendi Komunal është dhënë në shfrytëzim/menaxhim prona (parcela) me sipërfaqe prej 11,290m2 në zonën kadastrale Davidovc, Shtëmë, për ngritjen e objekteve afariste dhe ushtrimin e veprimtarisë sipas planit të biznesit, me qira vjetore prej 2,032€. Pas një ekzaminimi fizik të kësaj prone, ne kemi vërejtur se shfrytëzuesit të cilët iu kishte dhënë prona me qira, një pjesë të kësaj prone ia kishte dhënë në shfrytëzim palëve të treta, pra kjo pronë ishte duke u shfrytëzuar nga tre (3) subjekte apo shfrytëzues të tjerë për qëllime biznesore, një barnatore, një klinik dentare dhe një autolarje, që nuk ishin të kontraktuara/autorizuara nga komuna për shfrytëzimin e kësaj prone.

Mungesa e vendosjes së një mekanizmi efektiv për monitorimin e procesit të pronave komunale të cilat janë dhënë në shfrytëzim ka bërë që shfrytëzuesi i kontraktuar të pronës komunale ta jap tek palët e treta.

Ndikimi

Dhënia e pronës komunale nga ana e shfrytëzuesit të kontraktuar tek palëve të treta, duke ndryshuar formën e biznesit dhe shfrytëzuesve jo në pajtim me ligjin, rrezikon që prona e dhënë në shfrytëzim të mos e arrij objektivin për të cilin është dhënë në shfrytëzim fillimisht apo edhe mundet të keqpërdoret.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë menaxhim efikas të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, duke raportuar në raportet e tij gjashtë (6) mujore për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave nga shfrytëzuesit e pronës në raport me kushtet e përcaktuara në kontratë, në mënyrë që mos ju ipet prona palëve të treta për të cilat nuk e lejon legjislacioni në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,546,067€, prej tyre ishin shpenzuar 2,324,885€ apo rreth 91% të buxhetit final. Spenzimet për investime kapitale kanë të bëjnë me asfaltimin e rrugëve lokale, kanalizime, shpronësima, objekte arsimore e shëndetësore.

Çështja A3 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

Gjetja

Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se "Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik".

Menaxherët e kontratave/projekteve nuk e kanë mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik, menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve.

Kjo ka ndodh si rezultat i mungesës së funksionimit të kontrolleve të brendshme për ta kryer këtë proces nga ana e menaxherëve të projekteve.

Ndikimi

Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik, mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të marr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

3 Informacion i përbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	8,756,040	9,806,696	9,376,389	7,702,313	7,172,793
Grante Qeveritare - Buxheti	8,169,040	8,865,644	8,616,369	6,582,714	6,530,067
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	68,484	15,098
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	0	0	0	308,363	56,810
Të bartura nga viti i kaluar	0	352,849	273,758	261,935	161,366
Të hyrat vetanake	587,000	587,000	486,262	470,826	402,960
Donacionet vendore	0	1,203	0	9,864	6,493
Donacionet e jashtme	0	0	0	125	0

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,050,656€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së grantit të qeverisë me vlerë prej 696,604€, nga të hyrat e bartura nga viti paraprak me vlerë prej 352,849€, si dhe nga donacionet e brendshme me vlerë prej 1,203€.

Në vitin 2023 komuna e Shtëmes ka shpenzuar 96% të buxhetit përfundimtar, me një rritje të realizimit krahasuar me vitin 2022, ku realizimi ishte 89%. Shpjegimet për pozicionin aktual janë dhënë në detaje më poshtë.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

Tabela 2. Shpenzimet e fondave sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondave sipas kategorive ekonomike	8,756,040	9,806,696	9,376,389	7,702,313	7,172,793
Paget dhe mëdijtjet	4,599,185	5,296,645	5,295,789	4,308,370	4,337,631
Mallrat dhe shërbimet	1,206,288	1,308,984	1,190,007	987,545	847,662
Komunalitë	300,000	300,000	252,649	202,234	156,468
Subvencionet dhe transferet	300,000	355,000	313,059	182,839	155,917
Investimet Kapitale	2,350,567	2,546,067	2,324,885	2,021,325	1,675,116

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë si në vijim:


-Buxheti final për paga dhe mëdijtjet në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 697,460€. Kjo rritje është: 696,604€ nga Granti qeveritar dhe 856€ nga Granti i donatoreve.

-Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 102,696€, nga 102,349€ të hyrat vetanake dhe 347€ nga Granti i donatorëve.

-Buxheti final për subvencione kishte rritje për 55,000€, kjo rritje ishte nga të hyrat vetanake.

-Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar kishte rritje për 195,500€, kjo rritje ishte nga të hyrat vetanake.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

9.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të ndërmer veprime adekuate për një zgjidhje të përbashkët me AKP-në lidhur me obligimet e NSh-ve të cilat janë nën menaxhimin e tyre dhe të ish NSh-ve të privatizuara.	Nga testimet e kryera ne kemi vërejtur se ky rekomandim është adresuar.	I zbatuar
10.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, si dhe duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës ruajnë gjithë dokumentacionin e nevojshëm për llogaritë e arkëtueshme të shfrytëzimit të pronës publike.	Nuk janë ndërmarrë veprime nga menaxhmenti, për vendosjen e mekanizmave për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Detyrimet Kontigjente	Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme që zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për detyrimet kontigjente në mënyrë që prezantimi i tyre në Pasqyra Financiare Vjetore të jetë i saktë dhe i drejtë.	Komuna nuk ka arritur që të bëj prezantim të drejtë të detyrimeve kontigjente.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë buxhetimin dhe plotësimin me staf të mjaftueshëm të NJAB-së për të ndikuar në forcimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme në komunë.	Ky rekomandim konsiderohet i mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

Viora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Elvir Krasniqi, Udhëheqës i ekipit



Albana Sahiti, Anëtare e ekipit



Arian Zenelaj, Anëtar i ekipit



ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Koment i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Prezantim jo i plotë dhe i saktë i llogarive të arkëtueshme në PVF	Bazuar në gjetjen për prezantimin jo të saktë të llogarive të arkëtueshme në pasqyrat financiare në si organizatë kemi vendosur kontakte me AKP -në dhe jemi në process të konfirmimit nga ana e tyre për ndermarrjet për të cilat ne nuk kemi plotësuar formularin adekuat sipas nenit 7 Paragrafi 2.6.2 i shtojcës së Ligjit Nr. 04/I-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), edhe pse ne kemi komunikuar vazhdimisht përmes emailve zyrtare dhe shkresave për obligimet që kanë ndaj institucionit të cilin ne e përfaqsojmë.. Deri më tani nuk kemi konfirmim zyrtarë nga ana e tyre për ndermarrjet të cilat i kanë kaluar afatet ligjore.	E gjetura qëndron, pasi që komuna nuk ka dëshmi se ka bërë kërkesë brenda afatit ligjor në AKP, pasi që ndermarrja është futur në likuidim ku N.SH. Kooperativa Bujqësore Shtime me datë 09.09.2013 është futur në procesin e likuidimit dhe komuna ka pasur 45 ditë kohë për të bërë kërkesë për borgjin të cilën e kishte NSH ndaj komunës për tatimin në pronë.
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve.	Bazuar në gjetjet keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë 232,213€. Në si Organizat mund të dëshmojmë për shkresat e dërguara në thesarë me datë 12.12.2023 dhe 14.11.2023 e të cilat nuk janë marrë për bazë, edhe pse kemi pasur mjete të mjaftueshme në kategorinë e pagave Kërkojmë përfshirjen në raport ekzekutimin nga ana e thesarit. Të bashkangjitur mund ti gjeni edhe kërkesat për korigjim!	E gjetura qëndron, pasi që shpenzimet janë regjistruar në kategori jo adekuate edhe konfirmohet nga komuna në komentin e tyre.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

Prezantim jo i drejtë i detyrimeve kontigjente në PVF	<p>Sa i perket detyrimeve kontigjente ne si OB asnjehere nuk kemi marr te pakten asnje rekomandim qoft nga auditori i jashtem ose i brendshem per selektimin e tyre ne at se cilat jone obligime dhe cilat jone ne procedure.</p> <p>Ne anen tjetër ne, nese i selektojm keto lënd gjyqësore mbi 90% e tyre kane vendim te formes prer dhe kalojn nga detyrimet kontigjente ne obligime, ku pastaj ne si OB nuk mund te bejm asnje pagese te vitit aktual pa kryerjen e obligimeve te vitit paraprak. Dhe ne atehere jemi ne kolaps duke mos realizuar planin e planes per ato projekte qe jane jetesore per qetetaret e komunes se Shtimes duke e ditur buxhetin e vogel qe Komuna e Shtime ka.</p>	<p>E gjetura qëndron, pasi komuna obligimet financiare i ka paraqitur si detyrime kontigjente. Komuna edhe në raportin e auditimit për vitin 2022 ka pasur rekomandim lidhur me detyrimet kontigjente ku është kërkuar nga komuna të marr masat e nevojshme për prezantimin e saktë të plotë të detyrimeve kontigjente.</p>
Dobësi në menaxhimin e subvencioneve dhe transfereve	<p>Ketu thuhet se ka pasur parregullsi ne menaxhimin e subvencioneve; Nga ato mostra te cilat ika marr auditori kane qene dy raste ku njera ka pase te beje me nje pale i cili ka aplikuar per subvencione me dy emra ne dokument: a) Aplikacioni eshte mbushur me emer tjerer dhe kopja e leternjoffimit ka emer tjetër dhe komisioni pasi qe e ka pa kete e ka bere nje gabim teknik qe nuk e ka shiquar dokumentacionin ne teresi. Rasti tjetër i subvencioneve eshte te kriteret per faren e misrit. Ku kriter ka qene te gjithë fermeret qe mbjellin miser deri ne 2 hektar, ndersa perfitues kane qene edhe ata fermer mbi dy hektar per arsye pas perfundirnit te aplikimit te gjithë ata fermer qe kane aplikuar deri ne dy hektar kane qene perfitues dhe pastaj ka mbet sasi misrit dhe Komuna e ka shpernda edhe nje pjese te ata fermer mbi dy hektar.</p>	<p>E gjetura qëndron, pohimi nga komuna se një aplikant ka aplikuar per subvencione me dy emra në dosje të aplikimit ku aplikacioni është plotësuar me emër tjetër dhe kopja e leternjoffimit ka emër tjetër, është i pa saktë. Aplikuesi ka bashkangjitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe ka plotësuar të gjitha kriteret, derisa zyrtari pranues i aplikacionit në mbështjellësin e lëndës ka ngatërruar emrin e aplikuesit duke përshkruar gabim emrin e aplikuesit në fjalë. Qëndron fakti se komisioni nuk e ka trajtuar lëndën fare derisa të njëjtën e ka gjykuar vetëm nga mbështjellësi i lëndës. E gjetura qëndron, përkundër arsyetimeve nga ana e komunës, është vërtetuar fakti se nuk janë respektuar kriteret e thirrjes për të cilën edhe është raportuar gjetja.</p>

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

<p>Efikasitet i ulët në menaxhimin e llogarive të Arkëtueshme</p>	<p>Ne kemi arritur që gjatë vitit 2023 të zbresim të arkëtueshmet duke marrë edhe masa si duke mbajtur takime si dhe informacione njoftime të kohpaskohshme për detyrimet e tyre nga vitet paraprake shihet edhe në tabelën e prezantuar më poshtë ,andaj kerkojmë të theksohet edhe angazhimi i zyrës së tatimit në pronë për mbledhjen e të hyrave në raportin e auditimit që mund të themi se Komuna Shtime ka arritur të zbres të arkëtueshmet deri në masë 30%.</p>	<p>E gjetura qëndron, pasi që komuna me masat që ka ndërmarrë nuk ka rezultuar me uljen e llogarive të arkëtueshme, por është rezultat i faljes së borxhit prej 100€ për çdo tatimpagues të tatimit në pronë. Pra, komuna ka bërë falje e afërsisht 300,000€ të llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë. Llogaritë e Arkëtueshme sipas PFV në fund të vitit 2023 për tatimin në pronë ishte 528,016€. Po të mos ndodhte falja e borxhit prej 100€ për çdo tatimpagues, llogaritë e arkëtueshme do të ishin 828,016€. Pra, kemi një rritje prej 74,360€ në krahasim me vitin 2022.</p>
---	--	--

ZYRA KOMBETARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE



REPUBLIKA E KOSOVËS
RËPUBLIKA KOŠOVAREPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHËTËME
OPŠTINA ŠTIBLJE/MUNICIPALITY OF SHËTËME



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjejet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pjesëprave Financiare të Komunës së Shëtimit, për vitin 2023 (në tërësi e nëlehtë "Reporti");
- pajtohem pjesërisht me gjejet dhe rekomandimet dhe kam komentet për përmbajtjen e Raportit si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit t'ju dërgoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfaqësojë afatet kohore dhe sasinë përfaqëse për zbatimin e tyre.

Z. Qerriji Aju

Data: 21.07.2023
SHËTËME



ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit I kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit I kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

"E përhapur" është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafi e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.


ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

Shënime fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktiket e mira relevante në sektorin publik
- ² Reportet tjere janë kërkasë e nonit 2 të së Rregullores 01/2017 për Reportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktiket e mira.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME-
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Preedsdnika Opštine/ Mayor's Office.

Data/Datum/Date:	23.08.2024
Nr./Br./No:	02/ 899
Për/Za/To:	Kuvendi Komunal - Shtime
Nga/Od/From:	Drejtorja për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Drejtor, Grejtalb Emiri
Përnes/Preko/Through:	Kryetarit të Komunës, z. Qemajl Aliu
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim - Vendim për shfuqizimin e Vendimit Npi-01/189 i datës: 06.09.2012

Në bazë të neneve 12 (paragrafi 2, pika d) dhe 58, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 dhe Statutit të Komunës së Shtimes, neni 53; Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 neni 53, Drejtorja për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi përmes Kryetarit të Komunës paraqesim këtë Propozim – Vendim:

Shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës me Nr.Npi-01/189, i datës 06.09.2012, Për Dhënie në Shfrytëzim të Sipërfaqes prej 50 ari Truall Policisë së Kosovës – Njësia në Shtime.

Arsyetim: Shfuqizimi i Vendimit bëhet pasi që Objektit i Stacionit Policor në Shtime është dislokuar në një pjesë tjetër të qytetit dhe me qëllim të ri-destinimit të asaj zone për ndërtimin e Objektit për Banim të Përbalueshëm nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura.

Andaj, kërkohet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Shtimes ta aprovojnë këtë Propozim-Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr.Npi-01/189 i datës 06.09.2012 që është aprovuar unanimisht në Kuvendin e Komunës.

Bashkangjitur me Propozim - Vendimin gjeni:

- Vendimin Nr.Npi-01-189 i datës 06.09.2012,
- Certifikatën e pronës mbi parcelën e ndarë,
- Kopja e Planit të parcelës.

Adresa: Rr. Tahir Sinani, nr 50, 72000. Shtime, Republika e Kosovës.
Tel.: +383290389016, email: info@shtime-komuna.org
http://kk.rks-gov.net/shtime



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL-SHTIME
01Nr. 06/1695 Datë: 23.8.2012



Npi - 01/189, Datë: 6.9.2012

Kuvendi Komunal-Shtime, në mbledhjen e tetë, të rregullt për vitin 2012, të mbajtur më: 6.9.2012, shqyrtoi kërkesën, 04/01-05AR/463/12, datë:22.8.2012, të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Ferizaj drejtuar Kryetarit të Komunës së Shtimes z.Naim Ismajli, të cilët kanë kërkuar nga Kuvendi Komunal-Shtime, që t'i ndajë një parcelë (pronë të paluajtshme), për ndërtimin e një objekti për nevojat e Policisë Njësia në Shtime. Kërkesa arsyetohet me faktin se objekti i tanishëm është i vjetër dhe nuk mund të realizohen aktivitetet e përditshme policore në mënyrë të sukseshme, sikurse edhe mirmabjtja e ndërtesës është vështirësuar mjaft shumë.

Duke analizuar kërkesën e palës, mbi bazën e nenit 12.d, 14.1 dhe 17.c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 4, dhe 5 të Ligjit për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Nr.03/L-226, pastaj duke marrë parasysh edhe rekomandimet e Kryetarit të Komunës, dhe rekomandimet e Komitetit për Politik e Financa, Kuvendi Komunal-Shtime mori këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË SIPËRFAQES PREJ 50 ARI TRUALL
POLICISË SË KOSOVËS - NJËSIA NË SHTIME

I

Kuvendi Komunal - Shtime, në mbledhjen e tetë, të rregullt, për vitin 2012, të mbajtur më datën: 6.9.2012, unanimisht aprovoi vendimin që Policisë së Kosovës - Njësia në Shtime, t'i japë në shfrytëzim, për afat të pacaktuar, 50 (pesëdhjetë) ari sipërfaqe për ndërtimin e objektit të Policisë, me objektet përcjellëse, në ngastrën kadastrale 1398/1; Z.K. - Shtime; Evidentuar (Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal- Shtime).

II

Kuvendi Komunal, i Rekomandor: Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi që sipërfaqja prej 50 (pesëdhjetë) ari të definohet, në përputhje me këtë Vendim, duke respektuar Ligjin, Planin Urbanistik, Kushtet, dhe Kriteret për shfrytëzim.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit, MAPL-së.



Kryesuesi i Kuvendit
Kujtim Xhelili



Republika e Kosovës
 Republica Kosovo-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
 Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
 AGENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72809093-01398-5

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 1248/24
 Data dhe koha e tëshmit / Datum i vrene izdavanja / Date and time of submission: 23.08.2024 - 09:32
 Komuna / Opština / Municipality: SHITIME / STIMLJE / SHITME
 Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Shitime / Stimlje / Shitme
 Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: SHITIME / STIMLJE / SHITME


A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj kadastrske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vista Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vista Imovine Property Type	Zona U/R GIS	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Pershkrim Opis Description	Krijuar me daten Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72809093-01398-5	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvvena Imovina / Socially owned Land	Urban	5000		26.03.2014	14.12.2015

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postel Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar me datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
LUÇU XHURZHAN			26.03.2014	14.12.2015

Printuar nga / Odštampiran od / Printed by: Kadifje, Zeqir J. P-72809093-01398-5 |



Zyrtarë përgjigjës / Odgovorno lice / Official person






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
 MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN


Zyra Kadastrale Komunaie/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : SHTIME
 Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Shtime

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-72809093-01398-5	Parcelë / Parcela / Parcel	5000



Shkalla/Razmera/Scale: 1:823

Punoi/Obradio/Created: Kadrije Zeqa
 Nënshkrimi/Potpis/Signature: 
 Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 23.08.2024
 Koha/ Vreme/ Time: 09:37:26

1/1



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës së Shtimes

Data/Datum/Date:	22.08.2024
Nr./Br./No	02/898
Për/Za/To:	Kuvendi Komunal, z.Adnan Ademi
Nga/Od/From:	Kryetari i Komunës së Shtimes, z. Qemal Aliu
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim-Vendim për formimin e Komisionit komunal për Vlerësimin e Kërkesave për Emërtimin e Objekteve Publike në Komunën e Shtimes

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Shtimes,

Në bazë të nenit 12.2 shkronja (d) nenit 17. Shkronja o) të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28, dt. 04. qershor /2008); Nenit 18, 24 dhe nenit 54.8 të Statutit të Komunës së Shtimes, paraqesim këtë Propozim-Vendim për formimin e Komisionit komunal për Vlerësimin e Kërkesave për Emërtimin e Objekteve Publike në Komunën e Shtimes.

Komisioni komunal për Vlerësimin e Kërkesave për Emërtimin e Objekteve Publike në Komunën e Shtimes, është i përkohshëm. Komisioni obligohet të bëjë vlerësimin e kërkesave dhe propozimeve që i plotësojnë kushtet më së miri dhe t'i rekomandoj Kuvendit për aprovim.

Anëtarët e propozuar për Komisionin Komunal për Vlerësimin e Kërkesave për Emërtimin e Objekteve Publike në Komunën e Shtimes janë:

1. _____, përfaqësues nga pozita
2. _____, përfaqësues nga opozita
3. _____, përfaqësues nga ekzekutivi
4. _____, përfaqësues nga komuniteti intelektual
5. _____, përfaqësues nga shoqëria civile

Punët administrative dhe teknike në harmoni me Komisionin do përkujdeset t'i kryejë Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Direktorat za Budžet i Finansije

Data/Datum/Date:	23.08.2024
Nr./Br./No	11/151
Për/Za/To:	Komitetin për Politikë dhe Financa - Kuvendin Komunal
Përmes/Preko/Through:	Qemajl Aliu- Kryetar i Komunës
Nga/Od/From:	Kimete Ukaj, Zyrtar Kryesor Financiar
Lënda/Predmet/Subject :	Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2025 - 2027

Përshëndetje të nderuar, para jush po prezantojmë Planin Buxhetor Komunal për periudhën 2025 - 2027.

Plani buxhetor përmban:

- Tabela 4.1 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2025
- Tabela 4.2 Lista e projekteve kapitale ne Komunen e Shtimes per vitin 2025-2027
- Tabela 4.3 Shtojca D.Planifikimi i të Hyrave Vetanake Komonale për vitin 2025 -2027

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (Neni 40) dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Neni 61.), sot para Juve shpalosim planin buxhetor për vitin 2025 – 2026. Kam bindjen se Ju do të jepni ndihmën e tuaj profesionale rreth kësaj teme nga se aprovimi i buxhetit përbën bazament të rëndësishëm për zhvillimin e proceseve jetike komunale. Prandaj, çdo vërejtje e juaj e mbështetur në profesionalizëm e realizëm do të jetë ndihmesë për sukses të përbashkët.

Pasqyra e propozimit buxhetor 2025 – 2027 shërben për të siguruar informata në kontekst të vendimeve që kanë të bëjnë me aprovimin e tij nga Kuvendi Komunal.

Plani buxhetor komunal për periudhën 2025 - 2027 është zhvilluar dhe ka kaluar nëpër disa faza në përputhje me udhëzimet e MFPT - it siç janë:

1. Zhvillimi dhe publikimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale të shpenzimeve duke ju referuar Qarkores Buxhetore 2025/01 për komunat
2. Kryerja e shqyrtimit të prioriteteve të Buxhetit Komunal, përfshirë këtu edhe takimet publike
3. Referimi i Qarkores Buxhetore 2025/02 për komunat
4. Kriteret ligjore për alokimin final të Grantëve Qeveritare:
 - 89% për numër të popullatës
 - 6% për madhësi të territorit
 - 3% për popullatën pakicë
 - 2% për komunitetet me popullatë pakicë

- Planifikimi i buxhetit për vitin 2025 është bërë duke u bazuar në Qarkoren 2025/01 në të cilën janë bërë ndarjet sipas grantëve dhe projekcioni i të hyrave vetanake për komunën e Shtimes në këtë mënyrë:

Nr.	Përshkrimi	Shuma në €
1	Granti i Përgjithshëm	4,560,657
2	Granti Specifik i Arsimit	3,954,859
3	Granti Specifik i Shëndetësisë	1,203,406
4	Projeksioni i të hyrave vetanake për vitin 2025	858,258
5	Shërbimet Rezidenciale	200,000
Gjithsej buxheti		10,777,180

- Ndarja e stafit, shpenzimeve operative dhe kapitale për vitin 2025 është bërë duke u bazuar në Qarkoren 2025/02 në të cilën janë bërë ndarjet për komunën e Shtimes sipas Kategorive Ekonomike në këtë mënyrë:

Nr.	Përshkrimi	Shuma në €
1	Pagat për vitin 2025 me staf prej 738	5,998,886
2	Mallra dhe Shërbime	1,502,000
3	Shpenzime Komunale	230,000
4	Subvencione dhe Transfere	500,000
5	Shpenzime Kapitale	2,546,294
Gjithsej buxheti		10,777,180

Plani i grumbullimit të hyrave vetanake

Tabela: Shtojca D. në materialin e prezantuar paraqet planin afatmesëm të hyrave vetanake komunale për vitet 2025 -2027 në të gjitha kategoritë ekonomike e te hyrave vetanake,ndërsa në tabelën në vazhdim është vetëm projekzioni për vitin 2025.

Nr.	Përshkrimi i të hyrave për vitin 2025	Shuma në €
I - A	Të ardhurat direkte – tarifat dhe ngarkesat	665,108
I - B	Të ardhurat indirekte – pjesa që u takon komunave (gjobat në Komunikacion, gjykatë etj.)	102,400
II	Të ardhurat nga Arsimi	42,172
III	Të ardhurat nga Shëndetësia	48,578
	Gjithsej	858,258

Struktura vijuese e planifikuar për shpenzimeve buxhetore sipas Kategorive Ekonomike individuale për vitin 2025:

Nr.	Përshkrimi	Shuma në €	Struktura e shprehur në përqindje
1	Paga dhe mëditje	5,998,886	56.66
2	Mallra dhe shërbime	1,502,000	13.94
3	Shpenzime komunale	230,000	2.13
4	Subvencione dhe transfere	500,000	4.64
5	Shpenzime kapitale	2,546,294	23.63
	Gjithsej	10,777,180	100%

Ndarja e buxhetit sipas Programit Arsim dhe Shkencë

Nr.	Përshkrimi	Stafi	Shuma në €
1	Paga dhe mëditje	488	3,769,201
2	Mallra dhe shërbime		364,841
3	Shpenzime komunale		70,917
4	Subvencione dhe transfere		73,500
5	Shpenzime kapitale		235,998
	Gjithsej		4,514,457

Tabela 4.1 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve fillestare të komunës për vitin 2025

Kod. omari	Kod. programi	Kod. projekti	Kod. aktiviteti	Përshkrimi	Staffi 2021	Pagat dhe mëdijet	Malltrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencione të dhe	Shpenzimet kapitale	Totali
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l
617				TOTAL SHPENZIMET	738	5,998,886	1,502,000	230,000	500,000	2,546,294	10,777,180
				Grantet Qeveritare	738	5,960,886	1,367,038	230,000	230,000	2,130,938	9,918,922
				Të hyrat vetanake		38,000	134,962	-	270,000	415,296	858,258
				Financimi i jashtëm-Huamarrja							
160				Zyra e Kryetarit	21	205,700	5,000	-	-	-	-
				Grantet Qeveritare	21	205,700	5,000	-	10,000	-	220,700
				Të hyrat vetanake							210,700
				Financimi i jashtëm					10,000		10,000
16007				Zyra e Kryetarit	21	205,700	5,000	-	-	-	-
				Grantet Qeveritare	21	205,700	5,000	-	10,000	-	220,700
				Të hyrat vetanake	21	205,700	5,000	-		-	210,700
				Financimi i jashtëm					10,000		10,000
				Grantet Qeveritare							-
				Të hyrat vetanake							-
				Financimi i jashtëm							-
169				Zyra e Kuvendit Komunal	21	170,000	2,000	-	-	-	-
				Grantet Qeveritare	21	170,000	2,000	-	-	-	172,000
				Të hyrat vetanake							172,000
				Financimi i jashtëm							
163				Administrata dhe personeli	28	186,900	183,714	12,122	-	10,000	392,736
				Grantet Qeveritare	28	186,900	183,714	12,122	-	10,000	392,736
				Të hyrat vetanake							
				Financimi i jashtëm							
16307				Administrata	28	186,900	183,714	12,122	-	10,000	392,736
				Grantet Qeveritare	28	186,900	183,714	12,122	-	10,000	392,736
				Të hyrat vetanake							
				Financimi i jashtëm							
				Grantet Qeveritare							-
				Të hyrat vetanake							-
				Financimi i jashtëm							-
166				Inspektimet	1	11,000	-	-	-	104,281	115,281
				Grantet Qeveritare	1	11,000	-	-	-	104,281	115,281
				Të hyrat vetanake						35,000	46,000
				Financimi i jashtëm						69,281	69,281
1.5	167			Prekurimi	5	44,000	-	-	-	-	44,000
				Grantet Qeveritare	5	44,000	-	-	-	-	44,000
				Të hyrat vetanake							
				Financimi i jashtëm							
175				Buxheti dhe financat	15	127,000	5,742	-	-	-	132,742
				Grantet Qeveritare	15	127,000	5,742	-	-	-	132,742
				Të hyrat vetanake							
				Financimi i jashtëm							
17507				Buxheti	15	127,000	5,742	-	-	-	132,742
				Grantet Qeveritare	15	127,000	5,742	-	-	-	132,742
				Të hyrat vetanake							
				Financimi i jashtëm							
180				Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjencë	15	133,675	333,082	112,561	-	-	579,318
				Grantet Qeveritare	15	133,675	289,816	112,561	-	-	506,052
				Të hyrat vetanake			73,266	-	-	-	73,266
				Financimi i jashtëm							
18411				Zjarrfikësit dhe inspektimet	8	73,775	19,300	1,961	-	-	95,036
				Grantet Qeveritare	8	73,775	19,300	1,961	-	-	95,036
				Të hyrat vetanake							
				Financimi i jashtëm							
18451				Menaxhimi i katastrofave natyrore	7	59,900	313,782	110,600	-	-	484,282
				Grantet Qeveritare	7	59,900	240,516	110,600	-	-	411,016
				Të hyrat vetanake			73,266	-	-	-	73,266
				Financimi i jashtëm							

Departamenti i Buxhetit Komunal, MEF

Tabela 4.1. Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve fillestare të komunës për vitin 2025

Kod	Emri i programit	Kodi i programit	Niveli i programit	Përshkrimi	Staffi 2025	Pagat dhe madhësitë	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet Komunalet	Subvencione t dhe	Shpenzimet kapitale	Total
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l
195	Zyra e komuniteteve			Grantet Qeveritare							
				Të hyrat vetanake							
				Financimi i jashtëm							
470	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural			Grantet Qeveritare	4	39,000	14,964		139,766		193,730
				Të hyrat vetanake					57,000		110,964
				Financimi i jashtëm					82,766		82,766
				47047 Zhvillimi dhe inspektimi bujqësor	4	39,000	14,964		139,766		193,730
				Grantet Qeveritare	4	39,000	14,964				
				Të hyrat vetanake					57,000		110,964
				Financimi i jashtëm					82,766		82,766
				47087 Pylltaria dhe inspektimi							
				Grantet Qeveritare							
				Të hyrat vetanake							
				Financimi i jashtëm							
660	Planifikimi urban dhe mjedisor			Grantet Qeveritare	11	95,500	130,000			1,943,972	2,169,472
				Të hyrat vetanake						1,722,957	1,948,457
				Financimi i jashtëm						221,015	221,015
66340	Planifikimi urban dhe inspektimi			Grantet Qeveritare	11	88,955	130,000			1,943,972	2,162,927
				Të hyrat vetanake						1,722,957	1,941,912
				Financimi i jashtëm						221,015	221,015
480	Zhvillimi ekonomik			Grantet Qeveritare	6	49,600	4,203			145,000	198,803
				Të hyrat vetanake						60,000	113,803
Garat Komunale të Diturisë janë organizuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe OJQ "Pronet Academy" në objektin e Shkollës Filllore "Emin Duraku" në Shtime, ku janë shënuar këto rezultate:

1. ShFMU "Emin Duraku" – Shtime, Vendi i Parë,
2. ShFMU "Lasgush Poradeci" – Muzeqinë, Vendi i Dytë,
3. ShFMU "Bajram Curri" – Petrovë, Vendi i Dytë,
4. ShFMU "Abdullah Shabani" – Carralevë, Vendi i Tretë.

Nr.	Shkolla	Vendi	Vendi (I)	Vendi (II)	Vendi (III)	Gjithsej
1	ShFMU "A. Shabani"	Carralevë	6	5	9	20
2	ShFMU "B. Curri"	Petrovë	8	6	7	21
3	ShFMU "E. Duraku"	Shtime	9	13	6	28
4	ShFMU "I. Ajeti"	Pjetërshticë	3	4	9	16
5	ShFMU "H. Prishtina"	Godanc	5	6	3	14
6	ShFMU "L. Poradeci"	Muzeqinë	11	9	1	21
7	ShFMU "Skënderbeu"	Reçak	1	6	8	15
			43	49	43	135

Organizuar nga Kosova Makers League, më 30 qershor 2024, në Fakultetin Teknik në Prishtinë është mbajtur Gara e Robotikës KML OPEN 2023-24 për ciklin e ulët, ku kanë garuar gjithsej 90 grupe në nivel të Republikës së Kosovës.

Në Garën Finale të Robotikës në nivel të Kosovës, kanë garuar edhe nxënësit e ShF "Emin Duraku" nga Shtimja, siç është ekipi "Edu5Star5", i cili mentorohet nga Bekim Krasniqi. Ky ekip në Fazën Finale të Garës Robotikës, ka treguar performancë të jashtëzakonshme, duke zënë vendin e dytë në nivel vendi. Ndërsa ekipi tjetër i kësaj shkolle "Edu5un", i cili mentorohet nga Florinda Hoxha, arriti në vendin e 6. Kurse ekipi i SHFMU "Hasan Prishtina" me emrin "Fantastikët" që monitorohet nga mësuesi Kastriot Qarri është ranguar në vendin e 47.

Në Garën e Robotikës KML OPEN 2023-24 për Ciklin 6-9, në mesin e 350 ekipeve ka marrë pjesë edhe ekipi "The coders (Koduesit)" i SHFMU "Lasgush Poradeci", paralelja e ndarë në Rashincë, ku nxënësit e kësaj shkolle u renditën në vendin e 5-të në nivel të Republikës së Kosovës. Monitorues i këtij ekipi ishte mësimsdhënësi Adil Qorrolli. Në këtë garë ka marrë pjesë edhe SHFMU "Hasan Prishtina" nga Godanci me ekipin "Sfiduesit", të cilët u renditën në vendin e 68-të. Monitoruese e këtij ekipi është Vetona Gashi.

Në këtë garë ka marrë pjesë edhe ShMU "Emin Duraku", paralelja e ndarë në Davidovc me ekipin "winners", monitorues i të cilëve ishte mësimsdhënësi Shpresim Mahmuti. Ishin të renditur në vendin 80. I njëjti mësimsdhënësi ka marrë pjesë edhe me ekipin "Future" të SHFMU "Idriz Ajeti" nga Pjetërshtica, të cilët ishin të renditur në vendin e 130. Kurse ekipi i fundit me renditje 179 ishte "KT-Klubi i Teknologjisë" nga ShMU "Emin Duraku" me monitorues mësimsdhënësin Hetem Neziraj.

KML Open është gara e parë dhe më e madhe e këtij llojit në Kosovë, e cila është e dizajnuar për shkollat fillore: publike dhe private si dhe për qendrat që punojnë me fëmijë. Pajisja me të cilën zhvillohet liga është roboti edukativ mBot që ofron hyrje të thjeshtë në botën e robotikës, por mundëson edhe përdorim më të avansuar. Gara është e ndarë në dy kategori: klasët 1-5 dhe 6-9 të shkollës fillore. Qëllimi i garës është krijimi i një atmosfere pozitive dhe të shëndetshme, ku fëmijët do të garojnë duke e zgjidhur një "mision të ndërlikuar" me ndihmën e robotit.

Bursa për studentë

Më 16 prill 2024, Drejtoria Komunale e Arsimit ka shpallur Konkurs për Ndarjen e Bursave për studentë të Komunës së Shtimes për vitin akademik 2023/2024. Afati i aplikimit ka qenë 15 ditë (2 maj). Në vitin paraprak janë ndarë 80 bursa për studentë, ndërsa sivjet është rritur numri i tyre dhe do të ndahen 100 bursa për studentë. Shtimi i numrit të studentëve që do të marrin bursë, do të jetë një mbështetje e fuqishme dhe motiv shtesë, për studentët e dalluar që ta shtojnë përkushtimin e tyre në drejtimet e studimeve që ndjekin. Bursat do të ndahen për 10 (dhjetë) muaj dhe shuma mujore e tyre është 50 euro për student, gjegjësisht 500 euro për një vit. Deri në mbyllje të konkursit kanë aplikuar gjithsej 203 studentë. Komisioni prej pesë anëtarëve ka bërë përzgjedhjen e studentëve duke u bazuar në kriteret e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për studentë. Me këtë rast, bursë studentore kanë fituar 16 meshkuj dhe 84 femra. Prej tyre 24 studentë janë nga universitetet publike, kurse 76 studentë nga kolegjet private. Kësaj radhe, 2 studentë janë përfitues të bursës që studijojnë në Republikën Veriore të Maqedonisë.

Regjistrimi i fëmijëve në Institucionin Parshkollor "Albiona Asllani" në Shtime

Më 5. 6. 2024, Drejtoria Komunale e Arsimit ka shpallur konkursin publik për regjistrimin e fëmijëve në vitin shkollor 2024/2025 për plotësimin e vendeve të lira në

Institucionin Parashkollor "Albiona Asllani" në Shtime. Me këtë rast, më 12. 7. 2024 janë publikuar rezultatet:

Institucioni Parashkollor "Albiona Asllani" – Shtime				
Grup-mosha	Nr. klasave-dhomave	Të planifikuar	Të regjistruar	Të paregjistruar
09 muaj – 2 vjeç	1-Grupi i çerdhes	10	10	6
2 – 3 vjeç	1-Grupi i çerdhes	1	15	2
3 – 4 vjeç	1-Grupi i kopshtit	23	12	0
4 – 5 vjeç	1-Grupi i kopshtit	2	2	3
5 – 6 vjeç	1-Grupi parafillor	24	24	3
Gjithsej:	5	60	63	14

Sqarim: Nga viti shkollor 2023/2024 do të vazhdojnë qëndrimin në çerdhe edhe 77 fëmijë të tjerë, të cilët janë të grup-moshave të ndryshme.

Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë (I) për vitin shkollor 2024/2025

Sipas Planit Dinamik të Punës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime, ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë të arsimit fillor për vitin shkollor 2024/2025. Me këtë rast, DKA në bashkëpunim me shkollat e komunës së Shtimes nga data 15 maj – 15 qershor 2024 ka bërë regjistrimin e tyre në klasën e parë.

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) nr. 09-2023, në klasat e para të shkollave fillore të Komunës së Shtimes është bërë regjistrimi i fëmijëve, të cilët kanë mbushur moshën minimale 6-vjeçare. Numri i paraleleve të planifikuara për regjistrim të nxënësve në klasën e parë të arsimit fillor është 22 paralele, ku deri më tash janë regjistruar gjithsej: 332 filloristë, gjë që krahasuar me vitin paraprak kemi 26 nxënës më pak të regjistruar.

Numri i nxënësve të regjistruar në klasën e parë në vitin shkollor 2024/2025

Shkolla	Vendi	Klasa e parë		
		M	F	Gj
"Abdullah Shabani"	Carralevë	10	0	10
	Zborc	6	4	10
"Bajram Curri"	Petrovë	19	19	38
	Mollopolc	5	5	10
"Emin Duraku"	Shtime	53	70	123
	Belinc	5	3	8
	Lagje	4	4	8
	Davidovc	3	8	11
"Hasan Prishtina"	Godanc	15	12	27
"Idriz Ajeti"	Pjetërshticë	10	9	19
"Lasgush Poradeci"	Muzeqinë	7	3	10
	Gjurkovc	6	7	13
	Vojnovc	5	7	12
	Rashincë	5	6	11
	Gllavicë	2	3	5
"Skënderbeu"	Reçak	11	6	17
Gjithsej:		166	166	332

Vërejtje: Numri i nxënësve mund të rritet deri në shtator meqë në çdo vit të ri shkollor prindërit i sjellin fëmijët të regjistruohen edhe në fund të muajit gusht.

Organizime tjera në kuadër të institucioneve arsimore

Me rastin e 16 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës është shënuar **17 Shkurti** në të gjitha institucionet e arsimit me aktivitete të ndryshme.

Për nder të **7 Marsit – Ditës së Mësuesit** në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës së Shtimes është shënuar me aktivitete të ndryshme kjo ngjarje me rëndësi kulturore dhe historike. Gjatë kësaj dite, ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, në Bibliotekën Kombëtare në Prishtinë ka dhënë mirënjohje për mësimsdhënësit e dalluar, në mesin e të cilëve nga komuna e Shtimes është shpërblyer Besim Buja, arsimtar i biologjisë në SHFMU “Lasgush Poradeci” në Muzeqinë.

Ndërkaq, në sallën e Asamblesë Komunale në Shtime, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) ka organizuar një ceremoni festive kushtuar **7 Marsit – Ditës së Mësuesit**. Me këtë rast, DKA ka dhënë mirënjohje për mësimsdhënësit e dalluar, mirënjohje post-morem për mësimsdhënësit e ndjerë dhe mirënjohje për veteranët e arsimit.

Me rastin e **8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas**, Drejtoria Komunale e Arsimit për të gjitha punojnëset e institucioneve edukativo-arsimore të komunës së Shtimes ka dhuruar lule.

Në shenjë të ruajtjes së ambientit që na rrethon gjegjësisht **22 Prillit – Ditës së Tokës** nxënësit e shkollave bashkë me mësimsdhënësit e tyre kanë organizuar aktivitete të ndryshme duke mbjellur lule e drunj dekorativ nëpër oborre të shkollave.

Drejtoria Komunale e Arsimit së bashku me grupin punus ka përgatitur **Draft-Planin e Veprimit kunder braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në shkolla**, i cili në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Shtimes, të mbajtur më **29. 4. 2024** është miratuar pas diskutimit publik.

Më **17 maj 2024** për të gjithë nxënësit e klasave të para të komunës së Shtimes është organizuar shënimi i Festës së Abetares, me një program të pasur kulturo-artistik të gërshetuar me këngë, valle e recitime. Në shënimin e Festës së Abetares morën pjesë mësues, prindër, nxënës e të tjerë.

Më **7 maj 2024**, në Shkollën e Mesme të Ulët “Emin Duraku” të Shtimes nga Klubi i Gjelibër i kësaj shkolle është organizuar aktiviteti tashmë tradicional **“Sofra Shkollore, 2024”**. Tryeza shkollore ishte mbushur përplot me ushqime të llojllojshme, të përgatitur nga nxënësit e kësaj shkolle dhe prindërit e tyre. Ky aktivitet shkollor që organizohet për nëntë vite me radhë ka për qëllim sigurimin e një fondi për zhvillimin e aktiviteteve shkollore. Gjatë këtij aktiviteti, nxënësit e shkollës kanë shfaqur një program të pasur kulturo-artistik të gërshetuar me këngë, valle e recitime.

Për nder të **1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve** në institucionet tona arsimore janë organizuar aktivitete të ndryshme për fëmijë. Me këtë rast, në Institutin Parashkollor “Albiona Asllani” në Shtime janë shpërndarë dhurata simbolike për të gjithë grupmoshat e fëmijëve të çerdhës. Po ashtu, me rastin e kësaj dite nga DKA janë shpërndarë dhurata edhe për të gjithë fëmijët e klasave përgatitore. Në të gjitha institucionet shkollore, fëmijët kanë zhvilluar aktivitete sportive, muzikë, ngjyrosje, lojëra edukative e të tjerë.

Me rastin e 25 vjetorit të çlirimit të komunës së Shtimes, të gjitha institucionet arsimore kanë organizuar një varg aktivitete në kujtim të ditës historike të **12 Qershorit**.

Aktivitete sportive

DKA në bashkëpunim me Federatën e Sportit Shkollor të Republikës së Kosovës, kanë përzgjedhur nxënësit e ShFMU "Abdullah Shabani" dhe SHFMU "Lasgush Poradeci" për aktivitetin sportiv shkollor dimëror "Drejt Malit". Ky aktivitet është realizuar në Brezovicë, ku nxënësit e klasës së shtatë për një javë kanë mësuar skijimin dhe rregullat e këtij sporti dimëror. Gjithashtu kanë bërë aktivitete të shumta me lojëra të ndryshme, ku ishin prezent edhe shumë shkolla të tjera të Kosovës.

Në kuadër të garave shkollore, më 24 prill 2024 u mbajtën garat komonale në futsall, për shkollat e mesme të larta të Komunës së Shtimes. Këto gara u organizuan nga SHPKF dhe Sporti Shkollor në bashkëpunim me DKA-në dhe DKRS-në. Në garat në futsall triumfoi ekipi nga IAAP.

Mbrëmja e Maturës, 2024

Më 18 maj 2024 është organizuar Mbrëmja e Maturës për 340 nxënës të Gjimnazit "Naim Frashëri" (210) dhe të Institucionit të arsimit dhe Aftësimin Profesional (130), e cila është mbajtur në restorantin "BA - Place" në Davidovc. Këtë aktivitet e kanë organizuar drejtoritë e dy shkollave të lartshënuara. Për mbarëvajtjen dhe sigurinë u përkujdes gjatë gjithë kohës, Policia e Kosovës, me një organizim të shkëlqyeshëm. Nxënësit kanë kaluar këtë natë të hareshme me një atmosferë të mrekullueshme dhe pa asnjë ekces.

Shëtitjet njëditore nga nxënësit e klasave të nënta

Në fund të muajit maj dhe në fillim të muajit qershor 2024, për nxënësit e shtatë shkollave të mesme të ulëta, respektivisht për nxënësit e klasave të nënta është organizuar shëtitje njëditore nëpër territorin e Republikës së Kosovës. Zakonisht gjatë këtyre shëtitjeve, vizitohet qyteti i Prizrenit, gjegjësisht ndërtesa e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Kalaja e Prizrenit etj, mandej vizitohet vendburimi i lumit Drin i Bardhë që ka rrjedhën rrëzë malit të Rusolisë nga gurra e shpellës së Radavcit (Pejë), në 586 metra lartësi mbidetare, i cili përndryshe njihet si lumi më i madh i gjeografisë shqiptare. Vizitohet Prekazi legjendar prej ku ka nisur liria e Kosovës, Shpella e Mermertë e Gadimes, një nga vlerat më të bukura dhe më të rralla speleologjike në Evropë, vizitohen shpatijet e Sharrit siç është Prevala dhe Brezovica piktoreske, mandej Ujëvara e Mirushës në fshatin Llapçevë (Malishevë), Burimi i Istogut me rrjedhje prej 2,500 litra ujë në sekondë, i cili buron në lartësi mbidetare 480 metra si dhe vendbanime tjera turistike.

Organizimi i Piknikut për Nxënës Filloristë (I-V)

Për nxënësit e shkollave fillore (I – V), realizohet pikniku dy herë në vit, në fillim të vitit shkollor dhe në përfundim të vitit shkollor. Dita e Piknikut është ditë mësimi dhe organizohet brenda territorit të komunës së Shtimes, zakonisht në fshatin Llanisht. Meqenëse territori i komunës sonë është i vogël, me miratim paraprak të prindërve të nxënësve janë lejuar të vizitojnë Parkun Nacional "Gërmia" në Prishtinë, fshatin piktoresk të Jezercit (Ferizaj) dhe vende tjera.

Shënimi i Ditëve të Shkollave

Për çdo vit, shkollat e komunës së Shtimes, shënojnë ditat e tyre të shkollave. Programi i tyre ka përmbytur pjesë të zgjedhura artistike dhe profesionale, të cilin e kanë përgatitur mësimdhënësit dhe nxënësit. Ditat e shkollave në këtë vit shkollor janë shënuar më:

- 20 Maj – Dita e ShFMU “Lasgush Poradeci” në Muzeqinë;
- 27 Maj – Dita e Gjinnazit “Naim Frashëri” në Shtime;
- 29 Maj – Dita e ShFMU “Idriz Ajeti” në Pjetërshticë;
- 30 Maj – Dita e ShFMU “Bajram Curri” në Petrovë;
- 10 Qershor – Dita e ShFMU “Emin Duraku” në Shtime;
- 11 Qershor – Dita e ShFMU “Skënderbeu” në Reçak;
- 14 Qershor – Dita e ShFMU “Abdullah Shabani” në Carralevë.

Publikimi i revistave shkollore

Gjatë këtij viti shkollor, institucionet edukativo-arsimore të komunës sonë kanë publikuar revistat e tyre shkollore, ku janë trajtuar tema të ndryshme arsimore, pedagogjike, histori, art, poezi, pikturë etj..

1. Revista shkollore “Filizat” – ShFMU “Skënderbeu”
2. Revista shkollore “Leximi” – ShFMU “B. Curri”
3. Revista shkollore “Zëri ynë” – ShFMU “L. Poradeci”
4. Revista shkollore “Vizioni” – ShMU “E. Duraku”
5. Gazeta shkollore “Zenit” – Gjinnazi “N. Frashëri”

Java e Dyerve të Hapura në IAAP dhe Gjinnaz

Drejtorja e Arsimit, në bashkërendim me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta dhe MASHTI-n, në funksion të orientimit në karrierë dhe informimit të nxënësve të klasave të nënta (IX), me drejtimet (profilet) e shkollave të mesme të larta, nga data 22 – 26. 4. 2024 kanë organizuar aktivitetin “Java e dyerve të hapura”.

Për një informim sa më të detajuar, shkollat e mesme të larta, nxënësit vizitor i kanë njoftuar përmes informatave, si: Pankarta, prezantime mbi sukseset dhe rezultatet e shkollës, stafin e mësimdhënësve, kushtet brenda shkollës, ku nxënësit zhvillojnë praktikën profesionale, profilet që ofrojnë këto shkolla dhe mundësitë e inkuadrimit në tregun e punës pas përfundimit të shkollës së mesme profesionale. Pra, e gjithë kjo ka reflektuar pozitivisht, sepse nxënësit janë të mirë-informuar për mundësitë që ofrojnë këto shkolla në zhvillimin e tyre profesional dhe mundësitë për punësim pas përfundimit të shkollimit në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional (IAAP) në Shtime.

Java e Informimit në Gjinnaze për Orientim në Karrierë

Për orientim në karrierë janë zhvilluar një sërë aktivitete nga 22 – 26 prill 2024, të cilat janë përcaktuar për të ndihmuar nxënësit e klasave të XII-ta të zgjedhin drejtimet e tyre në arsimin e lartë. Ky aktivitet ka pasur për qëllim që nxënësit gjatë këtyre ditëve të marrin sa më shumë informata rreth mundësive ekzistuese për orientim në karrierë në Republikën e Kosovës. Kjo ka ndikuar fuqishëm tek nxënësit maturant në marrjen e vendimeve të mirëinformuara dhe vetëdijesimin e tyre të mirëfilltë për mundësitë egzistuese në zhvillimin e tyre profesional, vazhdimin e studimeve dhe punësimit të tyre pas përfundimit të arsimit të lartë. MASHTI ka siguruar materialet shtesë për organizimin e këtij aktiviteti duke përgatitur pankarta me mundësitë dhe informatat shtesë për orientim në karrierë.

Ceremonia e Diplomimit të Maturantëve

Më 14 qershor 2024, në ambientet e Shtëpisë së Kulturës në Shtime është mbajtur Ceremonia e Diplomimit të gjeneratës së maturantëve 2023/2024. Përmes kësaj ceremonie festive është shënuar përfundimi i një kapitulli të rëndësishëm dhe fillimi i një udhëtimi të ri për maturantët tanë që kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë në Gjimnazin “Naim Frashëri”.

Trajnimet e stafit arsimor dhe të nxënësve

Më 13-14 shkurt 2024, në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” është mbajtur trajnimi “Siguria dhe Shëndeti në Punë”, të cilin e ka organizuar falas organizata joqeveritare “Health and Safety Kosova” (HSK). Me këtë rast, janë trajnuar gjithsej 35 veta.

Po ashtu nga e njëjta organizatë, më 17 prill 2024, në IAAP është mbajtur trajnimi “Siguria dhe Shëndeti në Punë” për të gjithë nxënësit maturantë të kësaj shkolle. Të gjithë nxënësit pas kryerjes së këtij trajnimi janë pajisur me certifikatë nga HSK ALL. Trajnimi është realizuar në katër module:

1. Siguria dhe shëndeti në punë,
2. Dhënia e ndihmës së parë,
3. Ruajtja e ambientit dhe
4. Marrja e masave për parandalimin e zjarrit.

Ky trajnim është dëshmi shtesë se nxënësit e kësaj shkolle do të jenë të gatshëm për tregun e punës.

Më 23. 5. 2024, Forcat e Sigurisë të Kosovës kanë mbajtur ligjeratë me temën: “Edukimi për siguri” me nxënësit e IAAP-së

Më 24. 6. 2024 janë certifikuar gjashtë mësime të ShF “Emin Duraku” për trajnimin e ndjekur nga Play International Kosovo, me temën: “Diskriminimi në Bazë të Komunitetit”.

Nga data 20 – 24 shkurt 2024 është mbajtur ligjërata me temën “Dhuna në familje”, të cilën e kanë ndjekur 306 nxënës në shkollën e Petrovës, Mollopolcit, Muzeqinës dhe Rashincës;

Nga data 26 – 29 shkurt 2024 është mbajtur ligjërata me temën: “Substancat narkotike-drogat”, të cilën e kanë ndjekur 319 nxënës në shkollën e Reçakut, Petrovës, Pjetërshiticës dhe Gjurovcit;

Nga data 26 – 29 shkurt 2024 është organizuar: “Fusha për vetëdijesimin e këmbësorëve në trafikun rrugor” dhe janë shpërndarë 88 fletushka me përmbajtje të rregullave kryesisht për këmbësorët.

Në kuadër të projektit TAKE, më 29. 6. 2024 nga Caritasi Zviceran janë trajnuar edukatorët me temën: “Menaxhimi i klasës dhe grupeve në institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme”.

Në muajin qershor, në Qendrën e Inovacionit në Shtime, 90 nxënës (të moshës 8-18 vjeç) të të gjitha shkollave të komunës së Shtimes kanë filluar trajnimin në Programin: Dizajn Grafik dhe Gjuhë Angleze. Trajnimet është duke i mbajtur organizata “Flutura Academy”, konform marrëveshjes me Komunën e Shtimes, pra të gjitha shpenzimet janë pa pagesë për nxënësit.

Investime të rëndësishme

Në vazhden e digjitalizimit të institucioneve arsimore në Kosovë, më 26 prill 2024 në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Shtime, u bë lansimi i internetit të qëndrueshëm dhe të kontrolluar “Shkolla e 100-të”.

Ky investim ka për qëllim digjitalizimin dhe modernizimin e infrastrukturës telekomunikuese në institucionet arsimore të komunës sonë dhe në nivel vendi. Me këtë projekt janë të mbuluara shpenzimet e internetit për pesë vite.

Projekti Kosovo Digital Economy (KODE) i Ministrisë së Ekonomisë, ka sjellë përfitime të mëdha në Komunën tonë, duke siguruar një lidhje të qëndrueshme të internetit në shtatë objekte shkollore. Ky investim ndër të tjera ofron edhe mundësi të barabarta për nxënësit tanë, për të përmirësuar aftësitë e tyre që po njihen e dëshmohen gjithnjë e më shumë, si në nivelin vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar në fushën e teknologjisë. Përmes këtij projekti është bërë instalimi i rrjetit të internetit në këto institucione arsimore:

1. ShMU “Emin Duraku”-Shtime,
2. ShFMU “Lasgush Poradeci”-Muzeqinë,
3. ShFMU “Hasan Prishtina”-Godanc,
4. ShFMU “Skënderbeu”-Reçak,
5. ShFMU “Bajram Curri”-Petrovë,
6. Institucioni i Arsimit dhe Aftësimin Profesional-Shtime,
7. Gjimnazi “Naim Frashëri”-Shtime.

Projekte Kapitale në proces

Nr.	Arsim dhe shkencë
1	Renovimi i shkollës së Vojnocit, Petrovës, Emin Durakut, Lagje Pajtimit, Belincit dhe Naim Frashërit
3	Ndërtimi i sallave në Reçak dhe Zborc (faza e dytë)

4	Rregullimi i oborreve dhe rrethojave të shkollave: Carralevë, Gjyrkoc, IAAP, Davidoc dhe Çerdhe.
5	Funksionalizimi i sallave të Edukatës Fizike: Muzeqinë, Carralevë dhe Petrovë
8	Renovimi i Çerdhës së Vjetër në Shtime - MASHTI
9	Ndërtimi i Çerdhës së Fëmijëve në Godanc - MASHTI
10	Ndërtimi i aneksit në Petrovë dhe renovimi i shkollës aktuale - MASHTI
11	Ndërtimi i Çerdhës së Fëmijëve në Petrovë - MASHTI
12	Funksionalizimi i Çerdhës në fshatin Muzeqinë - MASHTI
13	Renovimi i ShFMU "Lasgush Poradeci" paralelja e ndarë në Vojnoc - MASHTI
14	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në Godanc - MASHTI

Më 19 qershor 2024 është përfunduar Observatori dhe Planetariumi i parë Kombëtar i Kosovës (OPKK) në fshatin Rashincë, i cili ka kushtuar mbi 300 mijë euro. Puna më pak se dy vjeçare dhe bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Komunës së Shtimes, Organizatës "Astronomy Outreach of Kosovo" e përmes tyre me kompaninë e prodhimit të teleskopëve, Celestron, kompanisë Sky-Watcher USA dhe organizatës amerikane Sunlit Earth!/The Charlie Bates Solar Astronomy Project, tash do t'i ofrojë të gjithëve mundësinë për të vëzhguar gjithësinë.

Observatori dhe Planetariumi do të ofrojë mundësi të shkëlqyera për edukimin shkencor dhe eksplorimin e hapësirës qiellore duke dhënë mundësi për shtim të diturisë për nxënësit, studentët dhe të gjithë entuziastët e astronomisë.

Gjithashtu, Komuna jonë përmes këtij projekti do të shndërrohet në një atraksion shkencor turistik ku do të merr vëmendje të gjerë ndërkombëtare për hulumtime astronomike, falë edhe faktit se këtu ndodhet edhe teleskopi më i madh për vëzhgim në Evropën Lindore, që përfundimisht na vendos në hartën e lokacioneve me rëndësi strategjike për kërkime shkencore astronomike.

Në qershor 2024 janë ndërtuar shkollat që të çojnë te Gjimnazi "Naim Frashëri" në Shtime në gjatësi prej 154 metra. Këto shkollë u mundësojnë nxënësve një qasje më të lehtë dhe më të sigurt të udhëtimit të tyre për shkuarje-ardhje. Ky investim është i Komunës së Shtimes në vlerë prej 45,849.50 euro.

Në qershor 2024, ShFMU "Abdullah Shabani" në Carralevë është furnizuar me një gjenerator të ri në vlerë 7990 mijë euro.

Më 16 gusht 2024, Drejtoria Komunale e Arsimit ka nisur një investim shumë i rëndësishëm dhe kërkuar me furnizimin e shkollave me inventar shkollor: Banka, karrige dhe tavolina pune për mësimdhënës. Me këtë rast janë furnizuar këto institucione arsimore: Shkolla në Gjyrkoc, Rashincë, Vojnoc, Zborc, Davidoc, Godanc, Mollopolc dhe Petrovë. Kostoja e këtij projekti ishte 28.994 euro.

Donacione për institucione arsimore

Më 24. 4. 2024, Biblioteka Kombëtare "Pjetër Bogdani" ka dhuruar për ShFMU "Emin Duraku" 260 tituj librash. Kjo ka pasuruar shkollën me libra të nevojshëm për nxënësit dhe mësuesit tanë! Përafësisht shkolla nga ky donacion ka përfutur afro 2000 ekzemplarë të librave të ndryshëm. Pasurimi i fondit librar shkollior do të ju mundëson nxënësve të këtij institucioni arsimor rritjen shkathësisë së leximit dhe dashurinë ndaj artit të shkruar për zhvillimin e tyre.

Më 13. 6. 2024, ShFMU "Abdullah Shabani" është pajisur me një teleskop solar në vlerë rreth 1000 euro. Ky teleskop është dhuruar për institucionin arsimor nga profesori Milaim Rushiti.

Më 25. 6. 2024 në ShFMU "Abdullah Shabani", paralelja e ndarë në Zborc, humanisti Zejadin Dedinca nga Obliqi, i cili jeton dhe punon në Montreal të Kanadasë, i ka dhuruar këtij institucioni arsimor një ilaptop dhe pesë shtëpiza që do të përdoren nga nxënësit në kabinetet mësimore të Teknologjisë Informativë. Një donacion të ngjashëm e kanë fituar edhe SHMU "Emin Duraku" në Shtime, ShFMU "Lasgush Poradeci", paralelja e ndarë në Vojnovc dhe ShFMU "Skënderbeu" në Reçak.

Vlerësimi i brendshëm për shkallë

Në kuadër të planifikimit të aktiviteteve arsimore, Shkolla Fillore "Emin Duraku", përkatësisht aktivi i klasave të dyta dhe të pesta kanë realizuar testin për shkallë, më 14 qershor 2024. Nxënësit e klasave të dyta janë vlerësuar për njohuritë e fituara në Shkallën 1 (Përvetësim themelor), kurse nxënësit e klasave të pesta janë vlerësuar për shkallën 2 (Përfundim dhe zhvillim)

Vlerësimi i brendshëm bëhet në nivelin shkollë/klasë nga mësuesit e lëndëve përkatëse dhe sipas përshkrimit të procedurave dhe kriterëve për secilin lloj të vlerësimit të brendshëm, të rregulluar me UA 8/2016.

Në Shkollën e Mesme të Ulët "Emin Duraku" në Shtime, më 19 qershor 2024 është mbajtur vlerësimi për shkallë që kishte për synim vlerësimin e nxënësve për shkathësitë e fituara sipas kompetencave. Për rezultatet pritet nga shkolla që ato të përpunohen dhe mbi bazën e tyre do të hartohen plane të punës që synojnë përmirësimin e performancës së nxënësve. Instrumenti për vlerësim ka pasur 80 kërkesa dhe ka përfshirë të gjitha kompetencat e parapara të KKK.

Më 18. 6. 2024, nxënësit e klasave të dyta dhe të pesta në të dy paralelet në shkollën amë në Carralevë si dhe në paralelen e ndarë në Zborc kanë matur njohuritë e tyre në arritjen e kompetencave kryesore të fushave kurrikulare për shkallën e I-rë dhe të II-të.

Ndërkaq, më 20. 6. 2024, nxënësit e klasave të VII-ta në të dy paralelet në shkollën amë në Carralevë si dhe në paralelen e ndarë në Zborc kanë matur njohuritë e tyre në arritjen e kompetencave kryesore të fushave kurrikulare për shkallën e III-të. Vlen të theksohet se vlerësimi i brendshëm shkollior do të ndikon edhe në ngritjen e cilësisë dhe arritjen e rezultateve të larta. Vlerësimi për shkallë realizohet në fund të çdo shkalle kurrikulare. Vlerësimi për shkallë është lloj i vlerësimit të brendshëm të nxënësve që realizohet nga shkolla, administrohet nga kryesuesit e Aktiveve profesionale brenda një shkalle kurrikulare. Vlerësimi u realizua bazuar në Udhëzimin Administrativ(MASHT) Nr. 08/2016 për Vlerësimin e Nxënësve sipas Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Neni 8. Vlerësimi për shkallë.

Më 21. 6. 2024, në ShFMU "Skënderbeu" është mbajtur vlerësimi për shkallë për klasën e dytë dhe pestë.

Vlerësimi i jashtëm i nxënësve

Divizioni për Standarde, Vlerësim dhe Monitorim që vepron në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në bashkëpunim me DKA-në bëjnë organizimin e përvitshëm të vlerësimit të jashtëm të nxënësve.

Më 30-31 maj 2024, në Gjinnazin "Naim Frashëri" dhe Shkollën e Mesme të Ulët "Emin Duraku" në Shtime është realizuar vlerësimi ndërkombëtar TIMSS (Studim Ndërkombëtar i Prirjeve në Matematikë dhe Shkencë), të cilit i janë nënshtruar gjithsej 93 nxënës të klasave të pesta (V) nga këto shkolla: ShF "Emin Duraku" në Shtime (41 nxënës), ShFMU "Lasgush Poradeci" Muzeqinë (26 nxënës) dhe ShFMU "Idriz Ajeti" në Pjetërshicë (26 nxënës). Ky test ka besueshmëri të lartë dhe ka ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e politikave arsimore të vendeve që marrin pjesë.

Më 22 qershor 2024 është organizuar Provimi Shtetëror i Maturës për vitin 2024, ku në komunën tonë këtij testi i janë nënshtruar gjithsej 275 nxënës maturantë. Testi në fjalë, është organizuar në tri qendra mësimore: Në IAAP, në Gjinnazin "Naim Frashëri" dhe në ShMU "Emin Duraku" në Shtime.

Divizioni për Standarde, Vlerësim dhe Monitorim, më 1 korrik 2024 ka bërë publike rezultatet. Shih më poshtë tabelën:

Rezultati i Testit të Maturës, 2024 (afati i qershorit) në formë tabelare në Gjinnazin "Naim Frashëri" në Shtime

Drejtimi	Nx. që kanë hyrë në provim	Nx. që kanë kaluar testin	Përqindja e kalueshmërisë
----------	----------------------------	---------------------------	---------------------------

Gjimnaz i Shkencave Natyrore	112	102	91.07
Gjimnaz i Shkencave Shoqërore	87	41	47.12
Gjithsej:	199	143	71.85 %

Rezultati i Testit të Maturës 2024 (afati i qershorit) në formë tabelare në IAAP në Shtime

	Drejtimi	Nx. që kanë hyrë në provim	Nx. që kanë kaluar testin	Përqindja e kalueshmërisë
Shkolla Profesionale (I)	Shëndetësi	22	18	81.81
Shkolla Profesionale (II)	Elektroteknikë	7	0	00.00
	Makineri	6	2	33.33
Shkolla Profesionale (III)	Ekonomi	22	5	22.72
	Administratë	14	2	14.28
	Hoteleri	5	1	20.00
Gjithsej:		76	28	36.84 %

Edhe këtë vit të gjithë maturantët, të cilët kanë kaluar Maturën Shtetërore janë pajisur me certifikatë nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Pra, siç shihet në tabelën e lartpërmendur, kalueshmëria e Testit Shtetëror të Maturës 2024 (në afatin e qershorit) në Gjimnazin "Naim Frashëri" ishte 71.85 për qind dhe krahasuar me vitin paraprak kemi ngritje për 19,14 për qind, ndërsa në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Shtime, kalueshmëria e Testit të Maturës sivjet ishte 36.84 për qind dhe krahasuar me vitin e kaluar edhe në këtë institucion arsimor kemi një ngritje prej 6.41 për qind.

Provimi i Maturës Shtetërore është një instrument matës, ku maturantët mund të tregojnë aftësitë dhe shkathhtësitë e tyre, të cilat i kanë përvetësuar gjatë tri viteve të shkollimit të mesëm të lartë (X-XII).

Për të gjithë ata nxënës që nuk kanë arritur të kalojnë në afatin e parë Provimin e Maturës Shtetërore, më 31 gusht 2024, do të jetë afati i dytë, ku sërish mund t'i nënshtrohen Maturës Shtetërore.

Më 25 qershor dhe 28 qershor 2024 është mbajtur Testi i Arritshmërisë, ku pjesa e parë ka përmbytur pyetjet nga lëndët shoqërore, ndërsa pjesa e dytë ka pasur pyetje për lëndët shkencore.

Më 25 qershor është mbajtur pjesa e parë e testimit e cila përmban njohuri nga gjuha amtare, gjuha angleze, historia dhe gjeografia.

Ndërkaq, më 28 qershor është mbajtur testimi i njohurive për lëndën e matematikës, informatikës, kimisë, fizikës dhe biologjisë.

Kjo mënyrë e organizimit të testimit ishte praktikuar edhe vitin e kaluar, me ç'rast nxënësit u testuan në dy data të ndryshme për lëndë të ndryshme. Testi i Arritshmërisë është mbajtur në tri qendra mësimore: Në ShMU "Emin Duraku", në Gjymnazin "Naim Frashëri" dhe në IAAP në Shtime.

Më 8 korrik 2024 nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit janë publikuar rezultatet e Testit të Arritshmërisë.

Rezultatet e Testit të Arritshmërisë sipas shkollave – 2024

Nr.	Emri i shkollës	Pjesa	Nr. i nxënësve	Nr. i pikëve	Përqindja	Mesatarja
1	ShFMU "Idriz Ajeti" – Pjetërshiticë	I	19	1033	54.36	45.90 %
		II	20	749	37.45	
2	ShFMU "Lasgush Poradeci" – Muzeqinë	I	57	2974	52.17	44.10 %
		II	55	1982	36.03	
3	ShMU "Emin Duraku" – Shtime	I	124	6401	51.62	43.45 %
		II	121	4262	35.28	
4	ShFMU "Skënderbeu" – Reçak	I	26	1337	51.42	42.13 %
		II	26	854	32.84	
5	ShFMU "Bajram Curri" – Petrovë	I	37	1683	45.48	40.78 %
		II	37	1335	36.08	
6	ShFMU "Abdullah Shabani" – Carralëvë	I	22	1063	48.31	39.74 %
		II	22	686	31.18	
7	ShFMU "Hasan Prishtina" – Godanc	I	47	2116	45.02	37.94 %
		II	47	1451	30.87	
Përqindja e përgjithshme:						42.00 %

Më 16 maj 2024 nxënësit maturantë kanë përfunduar klasën e 12-të, gjegjësisht shkollën e mesme të lartë;

Më 6 qershor 2024 nxënësit e klasave 9, 10 dhe 11-të kanë përfunduar vitin mësimor, kurse më 24 qershor 2024 ka përfunduar ky vit mësimor edhe për nxënësit e klasave 1 – 8.

Më 1 korrik 2024 kemi marrë katalogun e MASHTI-it për përzgjedhjen e teksteve shkollore për klasat 1-9 për vitin e ri shkollor 2024/2025, si dhe linçet e teksteve të shtëpive botuese fituese. Mandej, mësimdhënësit nëpërmjet linçeve kanë pasur mundësinë t'i lexojnë tekstei dhe t'i përzgjedhin shtëpitë botuese siç janë: "Libri shkollor", Media-Print", "Albas", "Dukagjini", "Europrinty" dhe "Pegi". Nga zyrtarët tanë ky katalog i plotësuar, më 8. 7. 2024 është dërguar në katër kopje fizike dhe në formë elektronike në Ministri të Arsimit.

Më 14 gusht 2024 në platformën shtetërore e-Kosova ka nisur aplikimi për subvencionimin e teksteve dhe mjeteve mësimore. Për këtë vit shkollior për mënësit nga klasa e 1-5, subvencionimi është 80 euro, ndërsa për nxënësit nga klasa 6-9 subvencionimi do të jetë me nga 110 euro.

Më 9 korrik 2024 është shpallur konkursi për regjistrimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë, në Gjinnazin "Naim Frashëri" dhe në IAAP. Afati për dorëzimin e dokumenteve ka qenë nga data 10, 11 dhe 12 korrik, kurse shpallja e rezultateve është bërë më 13. 7. 2024.

Gjinnazi "Naim Frashëri" – Shtime				
Drejtimi	Paralele	Të planifikuar	Të pranuar	Të papranuar
Gjinnazi i Shkencave Natyrore	3	75	43	24
Gjinnazi i Shkencave Shoqërore	4	100	10	71
Gjithsej:	7	175	53	95

Sqarim: Për afatin e gushtit janë të lira edhe 123 vende për regjistrim të nxënësve

Institucioni i Arsimit dhe Aftësisimit Profesional – Shtime					
Drejtimi	Profili	Paralele	Të planifikuar	Të pranuar	Të papranuar
Shëndetësi	Bashëpunëtor profesional infermerisë	1	25	16	7
Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Instalues ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit	1	20	19	0
	Informatikë	1	20	17	7
	Instalues elektrik	1	20	9	
Agrokulturë, pylltari, peshkatari dhe veterinari	Agrobiznes	1	20	7	0
Ekonomi, administratë dhe juridik	Tregti me pakicë dhe shumicë	1	20	16	0
	Asistent administratës	1	20	10	0
Shërbime	Asistent restoranti	1	20	4	0
Gjithsej:		8	165	98	14

Sqarim: Për afatin e gushtit janë të lira edhe 67 vende për regjistrim të nxënësve në arsimin e mesëm të lartë, ku shpallja e konkursit plotësues do të bëhet më 19 gusht 2024.

Në fillim të muajit korrik kemi bërë hormanizimin e orëve mësimore për vitin shkollior 2024/2025, si dhe kemi përgatitur konkursin për vendet e lira të punës. Ndërkaq, më 11. 7. 2024 kemi shpallur 17 vende të lira të punës, të cilat janë kryesisht të lëndëve deficitare: matematikë,

teknologji informative, fizikë, gjuhë gjermane etj. Po ashtu, në këtë periudhë kemi shpallur edhe gjatë pozita për drejtorë dhe zëvendës drejtor të institucioneve edukativo-arsimore.

Përfundimi i vitit mësimor dhe suksemi i nxënësve në arsimin parauniversitar (I – XII)

Viti mësimor ka përfunduar më 24 qershor 2024 në të gjitha shkollat e komunës së Shtimes. Institucionet shkollore kanë kompletuar suksesin e nxënësve për vitin mësimor 2023/2024.


Në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, bëjnë pjesë gjithsej 7 shkolla amë me 9 paralele të ndara fizike, ku mësimin, në vitin shkollor 2023/24, e kanë vijuar 3398 nxënës, të shpërndarë në 190 paralele, që i bie mesatarisht 17,88 nxënës për paralele, prej tyre: Në nivelin e arsimit fillor, I-V, janë 1878 nxënës, të shpërndarë në 110 paralele, mesatarisht 17,07 nxënës për paralele, ndërsa në nivelin e arsimit të mesëm të ulët, VI-IX, janë gjithsej 1520 nxënës, të shpërndarë në 80 paralele, mesatarisht 19,00 nxënës për paralele.

Ndërkaq, në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, X-XII, janë gjithsej 946 nxënës, të shpërndarë në 48 paralele, mesatarisht 19,70 nxënës për paralele.


Suksemi i nxënësve në vitin shkollor 2023/24 – Niveli e arsimit fillor (I-V)

Emri i shkollës	Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve			Kaluan klasën me sukses								Përcillen		Gjithsej orë gjatë vitit				
					Shënyeshëm		Shumë mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Me nota negative				Të pa notuar		
					Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			Nr	%	
"A. Shabani"	10	62	64	126	62	49.21	29	23.02	17	13.49	8	6.35	5	3.97	5	3.97	8363	8232	4
"B. Curri"	15	119	112	321	126	54.55	50	21.65	38	16.45	17	7.36	0	0.00	0	0.00	6011	5947	4
"E. Duraku"	40	424	410	834	479	57.43	165	19.78	131	15.71	35	4.20	11	1.32	13	1.56	17360	17011	4
"H. Prishtina"	10	92	79	171	91	53.22	44	25.73	27	15.79	9	5.26	0	0.00	0	0.00	4326	4318	4
"I. Ajeti"	5	52	53	105	55	52.38	32	30.48	11	10.48	3	2.86	0	0.00	4	3.81	4143	4091	4
"L. Poradeci"	25	162	133	295	181	61.36	53	17.97	35	11.86	17	5.76	8	2.71	1	0.34	10850	10835	4
"Skënderbeu"	5	69	47	116	58	50.00	23	19.83	26	22.41	8	6.90	1	0.86	0	0.00	2201	2188	3
Ithsej:	110	280	898	1878	1052	54.02	396	22.64	285	15.17	97	5.53	25	1.27	23	1.38	53254	52622	4

SUKSESI SIPAS PËRQINDJES




NOTAT MESATARE SIPAS SHKOLLAVE




Suksesi i nxënëseve në vitin shkollor 2023/24 – Niveli i arsimit të mesëm të ulët (VI-IX)

Emri i shkollës	Nr. i paneleve	Nr. i nxënëseve		Kallon klasën me sukses								Kanë përsëritur klasën		Te pa notuar		Gjithsej orë gjatë vitit:			
				Shëlyeshtina		Shumë mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Me nota negative	Te pa notuar			Të planifikuar	Të mbajtura		
				Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%							Nr	%
"A. Shehberi"	8	51	55	106	38	35.55	20	18.87	18	16.98	17	16.04	4	3.77	9	8.49	8616	7324	3
"B. Curri"	12	81	98	179	56	31.28	36	20.11	41	22.91	17	9.50	27	15.08	2	1.12	6626	6216	3
"E. Duraku"	28	317	321	638	139	21.79	129	20.22	160	25.08	103	16.14	99	15.52	8	1.25	15736	14543	3
"H. Prishtina"	8	85	74	159	27	16.98	44	27.67	44	27.67	30	18.87	14	8.81	0	0.00	4443	4262	3
"L. Ajeti"	4	45	35	81	24	29.63	19	23.46	26	32.10	10	12.35	0	0.00	2	2.47	4406	3955	3
"L. Porndeci"	16	147	104	251	36	14.26	60	23.90	67	26.69	34	13.55	4	1.59	0	0.00	8900	8675	4
"Skënderbeu"	4	59	47	106	22	20.75	32	30.19	15	14.15	9	8.49	25	23.58	3	2.83	2226	2019	3
fbsej:	80	753	737	1520	392	27.22	340	25.49	371	23.65	220	13.56	173	9.77	24	2.31	50953	46994	3

SUKSESI SIPAS PËRQINDJES







Suksesi i nxënësve në vitin shkollor 2023/24 - Niveli i arsimit të mesëm të lartë (X-XII)

Emri i shkollës	Nr. i paneleve	Nr. i nxënësve		Kalluan klasën me sukses								Karrë përshpirtur klasën		Të pa notuar		Ojthsej orë gjatë vitit			
				Shfrytësimi		Shumë mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Me nota negative	Të planifikuar			Të mbajtura			
				Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%						Nr	%	
"N. Frashëri"	23	232	293	525	81	15.43	120	22.86	177	33.71	117	22.29	5	0.95	25	4.76	11928	11107	3
IAAP	25	244	177	421	75	17.81	52	12.35	95	22.57	137	32.54	17	4.04	45	10.69	12743	12171	2
Itshetj:	48	536	410	946	156	16.62	172	17.66	272	28.14	254	27.41	22	2.50	70	7.73	24671	23278	2

SUKSESI SIPAS PËRQINDJES



NOTAT MESATARE SIPAS SHKOLLAVE



Fund



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës së Shtimes

Data/Datum/Date:	22.08.2024
Nr./Br./No.	02/ 897
Për/Za/To:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Shtimes
Nga/Od/From:	Kryetari i Komunës së Shtimes, z. Qemal Ali
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim-vendim për formimin e Komisionit komunal për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike dhe rishqyrtimin e kërkesave për riemërimin e rrugëve në territorin e Komunës së Shtimes

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Shtimes,

Në bazë të nenit 17. Shkronja o) të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28, dt. 04. qershor /2008); Nenit 18 dhe 24 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, dt.08 dhjetor 2011, dhe nenit 54.8 të Statutit të Komunës së Shtimes, paraqesim këtë Propozim-vendim për formimin e Komisionit komunal për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike dhe rishqyrtimin e kërkesave për riemërimin e rrugëve në territorin e Komunës së Shtimes.

Detyrë e Komisionit është të bëjë emërimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike si dhe rishqyrtimin e kërkesave për riemërimin e rrugëve në territorin Administrativ të Komunës së Shtimes në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave.

Anëtarët e propozuar për Komisionin komunal për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike dhe rishqyrtimin e kërkesave për riemërimin e rrugëve në territorin e Komunës së Shtimes janë:

1. _____, përfaqësues nga pozita
2. _____, përfaqësues nga opozita
3. _____, përfaqësues nga ekzekutivi
4. _____, përfaqësues nga ekzekutivi
5. _____, përfaqësues nga komuniteti intelektual
6. _____, përfaqësues nga komuniteti intelektual
7. _____, përfaqësues nga shoqëria civile

Punët administrative dhe teknike në harmoni me Komisionin do përkujdeset t'i kryejë Drejtoria për Urbanizëm, Mjedis dhe Kadastër. Afati kohor i vlefshmërisë së Komisionit është 2 vjet që nga dita e hyrjes në fuqi të Vendimit.